ISSN 1857-6443

LSDM-VMRO
Edhe një tentim për Prokurorinë Speciale

Fq.3

ANTIKORR-UPSIONI
Hetohen "gjykatësit svarovski"

Fq.5

NATO
Nazim Rashidi

Fq.10

www.koha.mk

Koha

Besimi i luhatur në BE

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3620 · e enjte, 28 mars 2019 · -1°c | 18°c · 15 DEN

EDITORIAL

Konkurrenca pastaj eksporti

Katër janë faktorët kryesor të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ata janë konsumi personal, investimi i biznesit, shpenzimet qeveritare dhe eksportet neto. Nëse e kemi parasysh se vështirë mund të realizohet kërkesa e biznesit që së paku 25 për qind e buxhetit të shkojë për investime kapitale ...

Fq.2

RAJON

Shqipëria po vuan pasojat e plakjes

Fq.14

GLOBI

Tensionet në Gaza mund të çojnë në pasoja katastrofike

Fq.15

FORUM

Fundi i paqes së Fuqive të Mëdha

Fq.11

KULTURA E DEBATIT POLITIK

PA "MEJDAN" MEDIATIK, S'BËHESH LIDER

Çfarë lideri politik është ai i cili nuk arrin të ballafaqohet me oponentin e tij për tema që janë me interes publik. Refuzimi për të mos e bërë këtë ballafaqim, në fakt është anashkalim i vëmendjes së publikut për shumë problematika që i trajton politika

Fq.4

Ligje për qytetarët, pa qytetarët!

Shkup, 27 mars - Shumica e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut shumë pak janë konsultuar para miratimit të ligjeve të ndryshme, ndërsa kryesisht gjatë procesit të miratimit të legjislacionit, më shumë dëgjohet zëri i biznesit, dhe fare pak i ai i organizatave të ndryshme joveqeritare, sindikatave e kështu me radhë. Sipas Anketës së realizuar nga ana e Institutit për Demokraci dhe Qendrës për Analiza Ekonomike, në vitin 2018, perceptimet apo përshtypjet e qytetarëve për procesin e ndikimit të rregullativës si proces që duhet të zbatojë çdo qeveri, në përgjithësi mbetet i panjohur për qytetarët. Thënë ndryshe, anketa tregon se në mënyrë të pamjaftueshme zbatohen konsultimet me të gjitha palët para miratimit të ligjeve të ndryshme. Njëherësh, 60 për qind e të anketuarve vlerësojnë se...

Fq.6

EDITORIAL

KONKURRENCA PASTAJ EKSPORTI

Fisnik Pasholli

Nëse i kthehemi realitetin tonë, nuk është pyetja a të eksportojmë apo ajo, por çka do të eksportojmë !. Apo cilat janë mundësitë dhe potencialet që ekonomia e jonë në aspekt strukturor të prodhojë që të tjerët nuk e prodhojnë, nuk munden apo nuk dëshirojnë ta prodhojnë

Katër janë faktorët kryesor të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ata janë konsumi personal, investimi i biznesit, shpenzimet qeveritare dhe eksportet neto.

Nëse e kemi parasysh se vështirë mund të realizohet kërkesa e biznesit që së paku 25 për qind e buxhetit të shkojë për investime kapitale për të mbështetur më shumë zhvillimin ekonomik të shtetit, se fitimi neto apo dallimi midis importit dhe eksportit është diku afër 280 milion euro nga puna e kompanive të huaja në zonat ekonomike, se pak kemi investime më serioze të kompanive vendore si rrjedhojë e mungesës së akumulimit të kapitalit dhe vështirësive të mëdha që të fitojnë kredi nga bankat vendore , dhe në fund dhe jo më e pak e rëndësishme se nga muaji në muaj, nga viti në vit po na ikën popullata , andaj edhe konsumi si një tregues mjaft i rëndësishëm i PPB, mbetet problematik në periudhën e ardhme, për shkak se konsumatorët që blejnë ushqime, bisedojnë në telefon, ndërtojnë shtëpia, apo harxhojnë në mënyra të tjera duke mbushur arkën e shtetit me TVSH, si kontribuesin kryesor, nuk i kemi dhe nuk do ti kemi këtu , por ato me punë, mundin dhe djersën e tyre do të kontribuojnë për zhvillimin e shteteve perëndimore. Njëherazi në një periudhë afatmesme do të ulen edhe remitancat e tyre, ku për shkak të bashkimit familjar ata nuk kenë se kujt ti dërgojnë para në vendlindje.

Ti kthehemi tani realitetin tonë ekonomik që udhëzon se vetëm pesë për qind e kompanive që punojnë dhe veprojnë jashtë zonave të lira ekonomike, edhe eksportojnë jashtë shtetit.

Analisti ekonomik Rudi Llazarevski rekomandon një mbështetje më të madhe dhe më serioze për kompanitë vendore që duhet të orientohen ndaj eksportit. Bile shton ai se Edhe Bullgaria fqinje ka një deficit apo plus në këmbimin tregtar me Gjermaninë prej 320 milion euro pa pjesëmarrjen e kompanive nga zonat eksterritoriale.

" Në tërë jetën time profesionale e kam përsëritur si papagaj një fjali e që thotë: Shtetet e vogla e kanë patjetër të prodhojnë dhe eksportojnë, nëse dëshirojnë të ushqehen. Disa firma e kanë dëgjuar këshillën time dhe sot dallohen shumë lehtë", vlerëson Llazarevski.

Edhe konkurrenca e ekonomisë vendore më së miri pasqyrohet në eksportin e prodhimeve vendore që lë për të dëshiruar.

Nënkryetarja e Lidhjes së Odave ekonomike të Maqedonisë Gabriela Kulebanova thotë se nga njëra anë vetëm 3500 kompani vendore eksportojnë, ndërsa nga ana tjetër mbi 80 të për qind të totalit të eksportit të shtetit e realizojnë kompanitë e mëdha. Andaj edhe janë të kuptueshme problemet e kompanive të vogla dhe të mesme në vend si pamundësia të investojnë në inovacione dhe teknologji, apo përkufizimi financiar, kadrovik dhe teknik për të realizuar eksportin. Andaj ajo kërkon në mënyrë më agresive stimulimin e vendosjes dhe zbatimit të teknologjisë së re, por edhe stimulimin e inovatorëve vendorë.

Në këtë drejtim mbetet sfida e shfrytëzimit më të madh të lehtësimeve ekzistuese fiskale për modernizimit e procesit prodhues, shfrytëzimin e fondeve të ndryshme për blerjen e pajisjeve të reja apo mbështetjen më të madhe të partneritetit me kompanitë e huaja.

Sfidë në të ardhmen mbetet edhe rritja e konkurrencës së ekonomisë vendore , ku Maqedonia e Veriut renditet ndër ekonomitë më të dobëta në Evropë lidhur me konkurrencën , për shkak se raporti i Forumit Global Ekonomik tregon se ekonomitë më konkurruese janë ato të orientuara në eksport , që kanë edhe nivel të lartë teknologjik dhe të inovacionit. Maqedonia në këtë vlerësim , notat më të mira i ka shënuar në fushën e shëndetësisë me 80 pikë nga 100 të mundshme, stabilitetin makroekonomik ku ka fituar 74.6 pikë dhe dinamizmin në biznes ku ka fituar 61.2 pikë.

Notat më të dobëta janë fituar në kapacitetin e inovacioneve me 31.1 për qind, madhësinë e tregut me 39.2 për qind, dhe funksionimin e institucioneve me 50.6 për qind . Më dobët si shtet në suaza globale jemi të renditur në pjesën e gjyqësorit, tregjet ku bizneset pak kanë qasje dhe në infrastrukturë.

Nëse i kthehemi realitetin tonë, nuk është pyetja a të eksportojmë apo ajo, por çka do të eksportojmë !. Apo cilat janë mundësitë dhe potencialet që ekonomia e jonë në aspekt strukturor të prodhojë që të tjerët nuk e prodhojnë, nuk munden apo nuk dëshirojnë ta prodhojnë. Përgjigjen në këtë duhet të ofrojnë më shumë faktorë të bazuar në një strategji afatgjate të zhvillimit që nuk do të ndryshojë, pa marrë parasysh se cila parti merr timonin e pushtetit. Në aspekt afatshkurtër, eksporti mund të rritet me lehtësimin e financimit ku firmat nuk do të duhet të ofrojnë 100 banesa për një makineri për të fituar kredi si garanci , menaxhimin më të mirë të harxhimeve, realizimin më thelbësor dhe konkret të reformave strukturore që përmirësojnë punën e biznesit ku shteti hiqet nga rruga me qëllim që biznesi të sjellë punësime dhe rezultate pozitive financiare, shkurton afatit e pagesës së borxheve , anulimin e procedurave të ndryshme të panevojshme, lidhjen më të fuqishme në klasterë. Në suaza afatgjate nevojitet një riorientim serioz i shtetit ndaj eksportit dhe realizimi i reformave në arsim, industri, zhvillimin e barabartë rajonal, përkujdesjen më të madhe për diasporën….



"SHQIPËRIA KAUKAZIANE: E VËRTETA E VONË"

"Shqipëria Kaukaziane; e vërteta e vonë", titullohet ky dokumentar mbi shqiptarët e Azerbajxhanit.
Dokumentari rrëfen mërgimin e hershëm të shqiptarëve në Kaukaz.
Ata i luteshin diellit e hënës dhe më vonë qenë të parët që përqafuan Kristianizmin.
Është interesante vetëdija e tyre e qartë e përkitësisë; qysh atëherë ata e quanin veten shqiptarë.
Kishin alfabetin, librat dhe kishat e tyre më të vjetrat në Kaukaz, dhe të pavarura prej Kishës Armene, e cila i luftoi për t'i dominuar, gjë që solli shpërngulje dhe shkatërrimin e gjithë librave në gjuhën shqipe. Mos e humbni këtë dokumentar, i cili hedh dritë jo vetëm mbi zanafillën e origjinës shqiptare, por gjithashtu hedh dritë edhe mbi vetë zanafillën e botës", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtarja nga Tirana, Arlinda Guma.

FATI I FËMIJËVE REFUGJATË

"Ajo që u shkrua dhe u tha deri më tani për fatin e refugjatëve kosovarë, pas bombardimeve të 24 Marsit, është një pikë ujë në det në krahasim me vuajtjet dhe përjetimet e tyre gjatë eksodit dhe qëndrimit të tyre nëpër kampe. Sipas të gjitha të dhënave ata që më së tepërmi pësuan, janë fëmijët. Bota e tyre fëmijërore u përmbys që nga momenti i arratisjes nga shtëpitë e tyre dhe shpërndarja nëpër rrugët e botës. Traumat që ata i përjetuan do t'i ndjekin gjatë tërë jetës dhe do të jenë vrragë të pashlyeshme në shpirtin e tyre të njomë....", ka shkruar një status në Facebook, artisti Osman Demiri.



E VETMJA TRIMËRI E PANUÇIT...

"Teksa pija kafenë dhe lexoja Panorama Sport më vërtitej në kokë për Panuçin, që refuzonte dorëheqjen, një anekdotë e vjetër dhe tashti që lexova në FB se Duka e ka hequr po e tregoj:
Shkoi njëri në ushtri në kohë lufte dhe u kthye shpejt dhe i tha gruas:
-Grua, dhjetë herë më thirrën "duart lart", por mezalllah se i ngrita...
-Sa trim je , o burrë, po pushkën ku e ke?
-E hodha se ika me vrap...
Kështu dhe ky, mazallah se i ngrinte duart përpjetë sa herë hante dru, derisa Duka ia mori pushkën. Më mirë vonë se kurrrë", ka shkruar një status në Facebook, prof. Bardhyl Matraxhiu

MEDIACitate

Shqiptarët nuk duan marrëveshje bazuar në modelin e dy Gjermanive

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se mundësitë për marrëveshje me shqiptarët e Kosovës janë "shumë më të vogla sesa kanë qenë" duke shtuar se Prishtina nuk do ta vazhdojë dialogun derisa të përfundojë mandati i administratës aktuale evropiane.
Zgjedhjet e reja për institucionet evropiane janë paparë të mbahen në fund të muajit maj.
Vuçiq përsëriti se Prishtina nuk do ta shfuqizojë së shpejti tarifën ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjës, përderisa përgjegjëse për këtë situatë e bëri edhe BE-në, që sipas tij, posedon mekanizma që do t'i kushtonin shumë shtrenjtë Prishtinës por që nuk po i zbaton.
"Pa një marrëveshje me Beogradin, Prishtina nuk mund të bëjë asnjëherë asgjë", tha presidenti serb.
Ai mohoi se ekziston një plan prej 17 pikësh për ndryshimin e kufijve me Kosovën. Presidenti serb tha gjithashtu se askush nuk e dëshiron një marrëveshje bazuar në modelin e dy Gjermanive.
"Shqiptarët më nuk duan të dëgjojnë për këtë, ata dyshojnë se Rusia do ta pranonte këtë në OKB, edhe nëse ne e pranojmë atë", tha Vuçiç.
Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë ndërprerë për shkak të vendosjes së tarifës ndaj mallrave serbe nga ana e Qeverisë së Kosovës.
Brukseli dhe Uashingtoni po bëjnë thirrje që palët të ndalin veprimet që dëmtojnë procesin negociator dhe të kthehen në tryezën e bisedimeve.
Vuçiq ka thënë se nuk është optimist sa i përket çështjes së Kosovës dhe ka shtuar se detyrimi i tij është që të ruajë popullin serb në Kosovë.
Kreu i shtetit serb mes tjerash për televizionin Happy ka theksuar se kanë nevojë për një paqe afatgjate me shqiptarët.
"Çdo mundësi për të folur do të përdoret për të dërguar një mesazh të mirë për popullin shqiptar, sepse ne kemi nevojë për paqe me ta, gjëja më e rëndësishme është ruajtja e një paqeje afatgjate, e cila nuk është pa zgjidhje", theksoi Vuçiq.
Ai shtoi se nuk duhet të vijë deri te marrëveshja dhe zgjidhja për Kosovën për një vit dhe se do të ishte sukses nëse do të arrinin një zgjidhje për pesë apo 10 vjet, krejt me qëllimin që të ketë paqe.

(Evropa e Lirë, 27 mars)

SOT TAKIM I RI LSDM-VMRO

EDHE NJË TENTIM PËR PSP-në

VMRO-DPMNE kërkon edhe formim të një Komisioni që të hetojë si deri më tani janë shpenzuar 15 milionë euro të dedikuara për PSP-në, sepse siç është shprehur Hristijan Mickovski, "ka indikacione se disa prej tyre nuk janë zgjidhur ligjërisht dhe se ka keqpërdorim të parave të qytetarëve"

Shkup, 27 mars - Ekipet e punës të LSDM-së dhe VMRO-së sot (e enjte) do të mbajnë takim të ri që të arrihet pajtueshmëri për ligjin për prokurorinë publike me të cilin duhet të zgjidhet statusi i ardhshëm i PSP-së. Takimi është caktuar për në orën 18 në Ministrinë e Drejtësisë, ndërkohë që të dyja palët edhe pse insistojnë në qëndrimet e veta, thonë se bisedimet nuk kanë dështuar.

VMRO e Mickovskit tashmë ka dorëzuar 65 amendamente për Ligjin për prokurori publike, me të cilin rregullohet edhe statusi i PSP-së. VMRO kërkon që PSP të bëhet sektor që do të merret me korrupsion të lartë në kuadër të Prokurorisë për përndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërsa LSDM-ja konsideron se ajo duhet të mbetet prokurori e veçantë në kuadër të sistemit të Prokurorisë Publike, e cila do të përgjigjet para prokurorit publik shtetëror. Kryeministri Zoran Zaev paralajmëroi se do të pranojë gjithçka që nuk do të nënkuptojë mbrojte të krimit dhe është konform Kushtetutës dhe ligjeve, ndërsa ka siguruar se PSP tashmë është kapacitet i krijuar institucional dhe nuk ka nevojë të shkatërrohet.

"PSP duhet të jetë departament në prokurorinë publike me ingerenca të qarta. Problemi për opozitën është qartë se dëshiron ta mbrojë krimin, dhe nuk e mbështet këtë ligj reformues. Përgjigjuni në pyetjen e thjeshtë: a dëshironi që Maqedonia e Veriut të përparojë apo dëshironi ta shihni të bllokuar dhe sërish të mos marrë datë për negociata, të cilën e presim nga vitit 2005?", ka shkruar në Fejsbuk kryeministri në porosinë drejtuar Mickoskit.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar se deri tek ata kanë arritur amendamentet për Ligjin për prokurorinë publike të VMRO-DPMNE-së, ndërsa dje janë zhvilluar konsultime për ligjin dhe me partitë më të vogla politike parlamentare. VMRO-DPMNE kërkon edhe formim të një Komisioni që të hetojë si deri më tani janë shpenzuar 15 milionë euro të dedikuara për PSP-në, sepse siç është shprehur Hristijan Mickovski, "ka indikacione se disa prej tyre nuk janë zgjidhur ligjërisht dhe se ka keqpërdorim të parave të qytetarëve". VMRO kërkon gjithashtu përbërje krejt të re të Prokurorisë Speciale, si dhe hetimin e gjithë punës së saj të bërë që nga formimi i këtij institucioni në vjeshtën e vitit 2015.

Nga ana tjetër, sipas propozimit të Qeverisë, Prokuroria Speciale duhet të vazhdojë punën me përbërjen e njëjtë, ndërsa nuk do të ketë të drejtë të përdorë si prova materiale bisedat nga afera e përgjimeve. Ndryshe, mandati për ngritjen e padive, kësaj prokurorie i ka skaduar në qershor të vitit 2017 dhe sipas Gjykatës Supreme ajo nuk ka të drejtë të procedojë asnjë nga lëndët gjyqësore që ka nisur pas kësaj date. *(Z.V)*

Publicitet

KULTURA E DEBATIT POLITIK

PA "MEJDAN" MEDIATIK, S'BËHESH LIDER

Çfarë lideri politik është ai i cili nuk arrin të ballafaqohet me oponentin e tij për tema që janë me interes publik. Refuzimi për të mos e bërë këtë ballafaqim, në fakt është anashkalim i vëmendjes së publikut për shumë problematika që i trajton politika

Koha — Destan JONUZI

Shkup, 27 mars - Debati i fundit televiziv midis kryeministrit dhe liderit të Lidhjes Social Demokrate të Maqedonisë së Veriut (LSDM), Zoran Zaev dhe liderit të VMRO-DPMNE-së, opozitare, Hristijan Mickoski edhe një herë nxori në shesh kulturën e ulët të komunikimit politik e cila u reflektua edhe në rrjetet sociale. Përderisa, ithtarët e politikave të Zaevit thonë se Mickoskin e ka bërë për "pesë pare", nga ana tjetër vmrovistët mbrojnë tezat se Mickoski edhe një herë u tregua stoik ndaj politikave dhe çështjeve kombëtare. Por, analisti Petar Arsovski vlerëson se Zaevi ka qenë në epërsi ndaj Mickoskit për arsye se ka politika të qarta, ndërsa tek lideri opozitarë mungon narrativi politik.

"Mendoj se liderët kanë kuptuar se nuk është tragjike që të paraqiten në debate. Shpresoj që kjo do të bëhet praktik edhe për në të ardhmen, pasi që duhet që liderët e partive politike të ballafaqohen në duele televizive. Kjo është mirë për demokracinë dhe për elektoratin. Në debatin e fundit në përparësi ka qenë Zaev, për arsye se Mickoski kishte problem me narrativin politik. Mickoski nuk ka plan të qartë. Plani i Zaevit mund t'iu pëlqej ose jo, por megjithatë ekziston. Nga ana tjetër lideri i opozitës nuk ka asnjë plan dhe ky është problemi i narrativit politik të tij, pasi që nuk kishte përgjigje në disa pyetje thelbësore", deklaroi për gazetën KOHA, analisti Petar Arsovski.

Ai thotë se deri sa Mickoski nuk distancohet nga politikat e qeverisë së Gruevskit dhe bartë mbi supe bagazhin e qeverisë së kaluar, nuk mund të reformoj as opozitën dhe nuk mund të del superior në asnjë duel televiziv. "Ai nuk mundi të distancohet nga ngjarjet e 27 prillit, nuk pati guxim të mbështes marrëveshjen e Prespës etj. Sipas kësaj mund të konstatohet se po bëhet e njëjta politik, po vazhdon avazi i njëjtë i politikbërjes së VMRO-së", thekson Arsovski. Nga ana tjetër, analisti Albert Musliu është i mendimit se debatet politike janë të frytshme për sistemet demokratike. Sipas tij një gjë e tillë duhet të parktikohet edhe në kampin politik shqiptar.

"Debate të liderëve politik shqiptarë nuk kemi pasur gjatë kohë. I fundit ka qenë ai midis Ali Ahmetit dhe Arbën Xhaferit. Ky është refleksion i nivelit politik. Unë uroj që të reflektojnë edhe liderët politik shqiptarë dhe të fillojnë këto debate të cilat janë karakteristik e demokracive të zhvilluara, për shkak se në shtete autoritare nuk ka debat. Që ta praktikojmë këtë punë, unë e kisha obliguar edhe me ligj. Të kenë obligim liderët që së paku një numër debatesh t'i kenë, për arsye se ajo është mënyra e drejtpërdrejt për t'i ballafaquar argumentet", deklaroi për gazetën KOHA, Albet Musliu, analist.

Sipas tij, Miskoski është hija e Gruevskit në politikën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, derisa nuk distancohet nga ai dhe keqpërdorimet e bëra nga pushteti i i kaluar i VMRO-DPMNE-së. "Mickoski e bartë bagazhin e Gruevskit deri sa nuk distancohet nga ai. Edhe në debatin e fundit Zaev insistonte që ai të distancohet prej keqbërjeve të VMRO-së, por ai nuk e bënte. Motivet mund vetëm se ti paramendojmë. Por, gjithsesi deri sa ai nuk distancohet prej krimit të Qeverisë së kaluar, keqbërjeve që ka bë qeveria e kaluar, ai atë bagazh do ta ketë në kurriz", vlerëson Musliu.

Edhe Arsovski edhe Musliu janë të mendimit se do të ishte mirë që debate televizive të ketë edhe në kampin politik shqiptar, por se nga praktika e deritanishme nuk besojnë se ata mund të ulen para syrit të kamerës. Fundja çfarë lideri politik është ai i cili nuk arrin të ballafaqohet me oponentin e tij për tema që janë me interes publik. Refuzimi për të mos e bërë këtë ballafaqim, në fakt është anashkalim i vëmendjes së publikut për shumë problematika që i trajton politika. Gjithsesi, nuk mundesh të jesh një lider i kompletuar nëse nuk del në 'mejdan' mediatik.

PJESËMARRËSIT TË MARRIM PËRGJEGJËSI PËR ZGJEDHJE TË PASTRA

Një delegacion partiak i LSDM-së i udhëhequr nga kryetari Zoran Zaev, dje është takuar me delegacionin e OSBE-së të udhëhequr nga shefi i misionit në vend, ambasadorin Klemens Koja. Në takim është biseduar rreth për më shumë tema aktuale me fokus në zgjedhjet presidenciale. Bashkërisht është konstatuar se në zgjedhjet e ardhshme presidenciale të gjithë pjesëmarrësit duhet të tregojnë pjekuri dhe përgjegjësi demokratike para shtetit, që qytetarët lirshëm ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës, ndërsa zgjedhjet të jenë korrekte dhe të drejta. "Sukses për ne do të jenë zgjedhje kristal të pastra, korrekte dhe demokratike. Si parti në pushtet obligohemi për këtë dhe presim nga të gjithë pjesëmarrësit të jenë më të përgjegjshëm. Shpresojmë se opozita nuk do të tentojë ta pengojë rë ardhmen e shtetit, do të ndërmarrim përgjegjësi dhe nuk do ta bllokojë raundin e dytë. Zgjedhje të suksesshme hapin hapësirë të madhe që reformat të vazhdojnë, Republika e Maqedonisë së Veriut të bëjnë hap të ri drejt integrimit në BE. Kjo është me interes të të gjithë qytetarëve tanë", tha kryetari Zaev. Misioni i OSBE-së tashmë është përfshirë në mënyrë aktive, vëzhguesit e OSBE-ODIHR me kujdes i ndjekin aktivitetet e procesit para dhe gjatë fushatës, punës së institucioneve, OSBE/ODIHR gjithashtu e ndjek edhe raportimin e mediave gjatë fushatës.

Maqedonia e Veriut në librat grekë

Athinë, 27 mars - Në librat grekë do të përfshihet emri i ri "Maqedonia e Veriut" siç parashikon Marrëveshja e Prespës për vendet fqinje, shkruan zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Markos Bolarois në përgjigje me shkrim të dhënë për pyetjet e deputetëve nga Demokracia e Re, raportoi korrespondentja e MIA-s nga Athina. Pyetja është dërguar nga deputetët Jorgos Kumucakos dhe Niki Karameos, të cilët e pyesin Ministrinë e Punëve të Jashtme të Greqisë, nëse në librat grekë ekzistojnë citate irredentiste, për të cilat Bolaris i përgjigjet negativisht. "Greqia si vende anëtare, midis të tjerave edhe OKB-ja, BE-ja dhe UNESKO, Këshilli i Evropës dhe OSBE-së, fuqishëm i respekton parimet e mospërdorimit të dhunës në marrëdhëniet midis shteteve, parimeve të fqinjësisë së mirë, të mos cenimit të kufijve dhe të shmangies së përdorimit të urrejtjes verbale në hartimin e librave që përdoren në Greqi. Sipas kësaj, në librat që janë në përdorim në Greqi nuk ekziston irredentizëm siç edhe është përmendur në nenin 9 paragrafi 5 nga Marrëveshja e Prespës, shkruan Bolaris në përgjigjen me shkrim.

Zgjedhjet të jenë korrekte, të mos kontestohet rezultati

Kriva Pallankë, 27 mars - Keni tre kandidatë të shkëlqyer për president dhe shteti duhet të krenohet me ta. Gara duhet të luhet në mënyrë korrekte, në atmosferë të qetë dhe demokratike dhe askush të mos i kontestojë rezultatet e zgjedhjeve, ka thënë kështu ambasadori francez Kristijan Timonie. "Kjo do të jetë shumë me rëndësi për vendimet në muajin qershor, të mund ta kthejë faqen e re nga 27 prilli, për realizimin e synimeve dhe interesave të përbashkëta, hyrje në BE dhe NATO", theksoi Timonie në takimin me kryetarin e Kriva Pallankës, Borhanço Micevski. Timonio mbrëmë e vizitoi Komunën e Kriva Pallankës me rastin e edicionit të 7 të Natës frankofone.

"MAGJAR TELEKOM" ANULOHET

BOGOEVSKI NUK PARAQITET NË GJYKATË

Lënda për "Magjar Telekomin", e cila tashmë përfaqësohet nga Prokuroria Speciale Publike, synon zbardhjen e mitëmarrjes të mbi 7 milionë eurove

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 27 mars - Për shkak angazhimeve në një grup pune në Qeveri, ish-agjenti sekret Sllobodan Bogoevski, të mërkurën nuk u paraqit në Gjykatën Penale të Shkupit, për të dëshmuar për rastin "Magjar Telekom". Gjykatësja e lëndës, Lenka Davitkova, para të pranishmëve e lexoi shkresën e cila kishte arritur deri te ajo nga vetë Bogoevski, me të cilën Trupi gjykues njoftohej se ai nuk do të mund të jetë i pranishëm në seancë.

Rrëfimi i dëshmitarit Bogoevski, për rastin "Magjar Telekom", pritej me interes të madh nga mediat, pasi që ai paraprakisht ishte pjesë e një procesi gjyqësor për "shpifje", kundër Ali Ahmetit dhe Musa Xhaferit.

Lënda për "Magjar Telekomin", e cila tashmë përfaqësohet nga Prokuroria Speciale Publike, synon zbardhjen e mitëmarrjes të mbi 7 milion eurove. Avokatët e të akuzuarve Atila Sendrei, Rollf Pllat dhe Zllotan Kishjakus, në seancën e fundit kërkuan që në bankën e dëshmitarëve të paraqitet edhe Vllado Buçkovski, ish-kryeministri (2002-2006). Prokurorja e lëndës, Lile Stefanova, para gazetarëve tha se rrethanat për të cilat mund të pyetet Buçkovski, nuk janë thelbësore. Mirëpo, në seancën e radhës, që pritet të mbahet me 24 prill, prokurorja speciale duhet të prononcohet nëse e pranon, ose jo që Buçkovski të deklarohet si dëshmitar.

Aktakuza e ngritur nga PSP, kundër Atila Sendrei dhe ish-anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të "Telekomit të Maqedonisë", Rollf Pllat, Mihaill Kefallijanis dhe Zoltan Kishjakus, thotë se të akuzuarit në fjalë dyshohen se kanë nënshkruar marrëveshje fiktive për shërbime konsultative me kompaninë "Çapteks Holldings Limited". Në këtë mënyrë sipas PSP, ata e kanë dëmtuar "Telekomin e Maqedonisë" me rreth 4 milionë euro, kurse buxhetin shtetëror të RMV-së me 2 milionë euro, sepse në atë kohë, Qeveria e RMV-së ka menaxhuar me 47 përqindëshin e aksioneve të ndërmarrjes "Telekomi i Maqedonisë".

Në llogarinë financiare të ndërmarrjes në Qipro, siç thuhet në aktakuzë janë transferuar mjete parash pa vendim të Bordit të Drejtorëve, kurse urdhrat i ka nënshkruar Sendrei, Pllati dhe Kishjakusi. Deri te GJPSH, aktakuza e parë për rastin "Magjar Telekom", është ngritur në vitin 2011-të, kurse seanca gjyqësore e parë, është mbajtur më 26 tetor të 2011-s. Gjykata në vitin 2008 pati shpallur fletarrest ndërkombëtar për Sendrein, Pllatin dhe Kishjakusin.

Të tre ish drejtorët e "Magjar Telekomit", Elleg Shtraub, Andrash Ballog dhe Tamash Morvai, në procedurën gjyqësore që u realizua njëkohësisht dhe për rastin e njëjtë në Hungari, janë akuzuar se në vitin 2005-të dhe 2006-të, funksionarëve të RMV-së u kanë paguar ryshfet në vlerë prej 4.8 milionë euro, që ta anulojnë liberalizimin e tregut te telekomunikimit. Të tre ish drejtorët i kanë paguar të hollat si shërbime konsultative dhe të marketingut.

Ndryshe, javën e kaluar me propozim të PSP-së, për rastin "Magjar Telekom", dëshmoi ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Xhemali Mehazi. Gjatë rrëfimit të tij, ai tha se ka kaluar shumë kohë nga kjo ngjarje dhe se nuk kujton se ka nënshkruar ndonjë dokument që lidhet me këtë rast.

ANTIKORRUPSIONI NIS PROCEDURAT PËR PËRGJEGJËSI

HETOHEN "GJYKATËSIT SVAROVSKI"

Shkup, 27 mars - Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit me iniciativë personale në seancën e djeshme ka vendosur të hapë lëndë për keqpërdorime dhe veprime korruptuese të gjykatësve Vladimir Pançevski, Jovo Vangelovski, Aleksandra Zafirovska, Svetlana Kostova dhe Sofija Laliçiq.

"Pas marrjes së njohurive nga Raporti i Departamentit Amerikan për të drejtat e njeriut për vitin 2018 për Republikën e Maqedonisë së Veriut për keqpërdorime dhe veprime korruptuese të gjykatësve të theksuar individualisht, Komisioni konkludoi të kryejë kontroll të të dhënave nga listat anketuese dhe deklaratat për interesat e personave në vijim: Vladimir Pançevski, Jovo Vangelovski, Aleksandra Zafirovska, Svetlana Kostova dhe Sofija Laliçiq", ka thënë kryetarja e KSHPK, Biljana Ivanovska. Ajo shtoi se Komisioni do ta analizojë gjendjen dhe përplasjen e interesave për Jordan Tasevskin dhe për Marija Dimitrievskën, niçi dhe mbesa e Vladimir Pançevskit nga Gjykata penale dhe për Maja Ristovskën, bashkëshorte e ish-ministrit Spiro Ristovski, e punësuar në MASIT.

Do të hapin procedurë për konfirmimin e rreziqeve për arritjen e marrëveshjeve korruptuese në procedurat e furnizimeve publike gjatë përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë për përpunim dhe revizion të planeve të detajuara urbanistike për Komunën Qendër. Sipas pozitës zyrtare në seancën e sotme, Antikorrupsioni miratoi vendim për hapjen e lëndës për listën e 18 personave të cilat kryejnë dy ose më shumë funksione në të njëjtën kohë. Komisioni antikorrupsion në seancën e sotme të shtatë e miratoi Programin vjetor për punë për vitin 2019 dhe planin e veprimit me kornizë kohore dhe dinamikë të aktiviteteve. Në pajtim me Propozimin e Planit vjetor për ndjekjen e gjendjes pronësore dhe përplasjes së interesave për vitin 2019 do të bëhet kontroll të gjendjes pronësore edhe të deklaratave të: deputetëve në Kuvend, anëtarëve të Qeverisë, anëtarëve të Qeverisë në përbërjen paraprake,drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të NP-ve në pronësi shtetërore dhe drejtorëve të SHA-ve në pronësi shtetërore.

Sipas Planit vjetor për punësim në vitin 2019 është paraparë që në Komision me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të tij dhe zbatimit të kompetencave të reja dhe të zgjeruara dhe zbatimin e kompetencave të reja dhe të zgjedhura në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe përplasjes së interesave që të punësohen 11 persona të rinj, ndërsa 15 të avancohen. Për këtë aktivitet pritet mbështetje nga donacionet ndërkombëtare. Është miratuar edhe Propozim-strategjia financiare për vitin 2020-2022, me të cilin siç u lavdëruan antikorrupsionerët, nuk janë të parapara shpenzime për reprezentacion dhe për automjete zyrtare, ndërsa në parim parashihet rritje e mjeteve për punësime të reja dhe për avancimin e të punësuarve aktual. Në vitin 2018 në Komision nuk janë realizuar punësime të reja as avancime për shkak të jofunksionalitetit të tij. *(Q.A)*

Shkup, shtatë aksidente me katër të lënduar

Shkup, 27 mars - Katër persona kanë marrë lëndime të lehta trupore në katër prej gjithsej shtatë aksidenteve gjatë ditës së djeshme. Në tri ishin shkaktuar dëme materiale. Nga SPB Shkup informojnë se dje policia rrugore ka sanksionuar 40 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, shtatë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritën e kuqe, dy shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve në vijat e shënuara për ta, dy shoferë për rreshtim të parregullt, një shofer për anashkalim të padrejtë, një shofer nuk u ka dhënë përparësi kalimi automjeteve në zonën e udhëkryqit, 11 shoferë për mos mbajtjen e helmetave mbrojtëse, tetë shoferë për mosmbajtjen e rripit të sigurimit dhe 44 shoferë të cilët e kanë shfrytëzuar celularin gjatë drejtimit të automjeteve. Nga komunikacioni ishte përjashtuar një shofer i cili voziste nën ndikimin e alkoolit, 22 shoferë para se të marrin lejen për vozitje dhe dy shoferë fillestarë, si dhe pesë automjete teknikisht jo në rregull, dhe 18 automjete të paregjistruara. Janë kapur 104 automjete të parkuara jo në rregull, ndërsa me ndihmën e automjetit special "karrotreci", janë larguar 88 automjete.

Fundjava fillon me llogaritjen verore të kohës

Shkup, 27 mars - Vikendi mbaron me llogaritjen dimërore të kohës dhe me zhvendosjen e akrepave të orës fillon llogaritja verore e kohës. Sipas vendimit që e solli Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e 124-t llogaritja verore në vitin 2019 fillon më 31 mars në orën 02h 00m 00s me zhvendosjen e akrepave për një orë para ora do të llogaritet si ora 03h 00m 00s. Llogaritja verore e kohës në vitin 2019 mbaron më 27 tetor ku ora 03h 00min 00s, me zhvendosjen e akrepave për një orë prapa koha prej orës 03h 00m 00s konsiderohet si 02h 00m 00s. Ky vendim është në pajtim me nenin 5 nga Direktiva 2000/84/ES OJ: JOL2001031R002102 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian prej 19.012001 për marrëveshjet e planit për llogaritjen verore dhe Informata e Komisionit Evropian në pajtim me nenin 4 të Direktivës, e publikuar në Gazetën Zyrtare të BE-së nr. 61, 17.2.2016.
Miratimi i këtij vendimi, siç thuhet në kumtesë, kontribuon në ndjekjen e politikës afatgjate ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për asociim drejt Bashkimit Evropian, si dhe mbajtja e llogarisë për funksionimin e papengueshëm të sektorëve të caktuar jo vetëm për transport.

KRONIKË

Arrestohen dy të rinj nga Radusha, policia u gjeti marihuanë

Të martën rreth orës 18 e 15 minuta në rrugën "Boris Kidriç" në Tetovë, pjesëtarë të policisë së Tetovës kanë arrestuar 23 vjeçarin B.F dhe një 17 vjeçar, që të dy nga fshati Radushë. Gjatë kontrollit ndaj tyre është gjetur marihuanë. Sektori për punë të brendshme në Tetovë njoftoi se pasi që atyre iu është gjetur marihuanë, janë mbajtur në stacionin policor për procedurë të mëtejshme.

Tetovarja aksidenton dy persona në udhëkryq

Në kryqëzimin e bulevardit "Ilinden", me kthesën për në Bërvenicë, të martën rreth orës 17 e 40 minuta, veturë e tipit Opel Vektra, me targa të Tetovës, e drejtuar nga Sh.F 24 vjeçare, ka aksidentuar dy këmbësorë të moshës 16 vjeçare, njëri nga Tetova dhe tjetri nga fshati Sellcë. Drejtuesja e veturës ka lëshuar vendin e ngjarjes, kurse një orë më pas vet është paraqitur në Stacionin policor në Tetovë. Dy këmbësorët e aksidentuar janë dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin klinik të Tetovës. Është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Largohen nga komunikacioni autobusët pa frena

Në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit, gjatë ditës së martë, është realizuar aksion kontrollues ndaj automjeteve që kryejnë transport publik të udhëtarëve, autobusë dhe kombi furgon. Gjatë kontrolleve, janë përfshirë 14 automjete, prej të cilëve 3 në Tetovë dhe 11 në Gostivar. Me këtë rast, gjatë kontrolleve është konstatuar se tek 6 automjete ka parregullsi teknike, një në Tetovë dhe 5 në Gostivar. Pesë prej këtyre automjeteve për transport të udhëtarëve kanë patur probleme me frenimin, ndërsa një ka patur problem me pajisjen e drejtimit. Për shkak të këtyre parregullsive, janë përgatitur edhe padi adekuate. Po ashtu, sipas policisë, janë kontrolluar edhe tre motoçiklistë tek të cilët është konstatuar se marrin pjesë në komunikacion në mënyrë të parregullt, respektivisht pa leje për qarkullim, me afat të skaduar dhe një nuk ka përdorur pajisje mbrojtëse. Ndaj këtyre tre motoçiklistëve do të ketë edhe padi adekuate. (U.H)

ANKETË E INSTITUTIT PËR DEMOKRACI

LIGJE PËR QYTETARËT, PA QYTETARËT!

Shumica e qytetarëve shumë pak janë konsultuar para miratimit të ligjeve të ndryshme, ndërsa kryesisht gjatë procesit të miratimit të legjislacionit, më shumë dëgjohet zëri i biznesit dhe fare pak i ai i organizatave të ndryshme joveqeritare, sindikatave...

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 27 mars - Shumica e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut shumë pak janë konsultuar para miratimit të ligjeve të ndryshme, ndërsa kryesisht gjatë procesit të miratimit të legjislacionit, më shumë dëgjohet zëri i biznesit, dhe fare pak i ai i organizatave të ndryshme joveqeritare, sindikatave e kështu me radhë. Sipas Anketës së realizuar nga ana e Institutit për Demokraci dhe Qendrës për Analiza Ekonomike, në vitin 2018, perceptimet apo përshtypjet e qytetarëve për procesin e ndikimit të rregullativës si proces që duhet të zbatojë çdo qeveri, në përgjithësi mbetet i panjohur për qytetarët.

Thënë ndryshe, anketa tregon se në mënyrë të pamjaftueshme zbatohen konsultimet me të gjitha palët para miratimit të ligjeve të ndryshme. Njëherësh, 60 për qind e të anketuarve vlerësojnë se nuk bëhet përllogaritja nga ana e Parlamentit dhe Qeverisë lidhur me harxhimet e ndryshme që mund të shkaktojnë miratimi i legjislacionit.

"Gjetjet e analizës udhëzojnë se në mënyrë shtesë është përforcuar perceptimi se gjatë përgatitjes së ligjeve, nuk shfrytëzohen hulumtimet dhe analizat dhe se konsultimet me palët e prekura janë të rralla. Është përforcuar edhe perceptimi se ligjet nuk duhet të miratohen me procedurë të përshpejtuar, ndërsa qytetarët dhe organizatat joqeveritare çdoherë duhet të kenë mundësi të komentojnë propozimligjet", thonë Jane Dimeski nga Instituti për Demokraci. Sipas tij, nga qytetarët e anketuar bile 87 për qind janë përgjigjur se nuk kanë dëgjuar për një proces të tillë që është për 9 për qind më shumë se në vitin 2017, 12 për qind janë përgjigjur pozitivisht, apo 2 për qind më shumë se në vitin paraprak. Ai shton se në raport me vitin 2017, në vitin 2018 vërehet trendi i njohjes më të madhe të të punësuarve në institucionet publike për procesin e vlerësimit të ndikimit ndaj rregullativës.

Dimeski më tej shton se anketa për vitin e kaluar ka treguar se për qytetarët, në 2018 gjatë miratimit të ligjeve, më me rëndësi është ndikimi ekonomik se sa ai social, për dallim prej vitit 2017, kur anketa ka treguar se ndikimi ekonomik dhe social kanë vlerë të njëjtë.

Andaj, tha Dimeski, në të ardhmen sugjerohet që institucionet shtetërore ti kushtojnë një vëmendje më të madhe fushatave informative dhe trajnimeve për të punësuarit në administratë për procesin, përfitimet dhe pasojat e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës. Njëherazi, institucionet shtetërore nevojitet të publikojnë draft versionet apo ndryshimet ligjore si dhe të përfshijnë opinionin publik në përgatitjen e legjislacionit të ri që nga fillimi. Nevojitet edhe sa më pak të shfrytëzohet miratimi i ligjeve me procedurë të shpejtë.

Vlerësohet se me realizimin e procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës, do të kontribuohet për një cilësi më të lartë të legjislacionit, do të rritet përfshirja e qytetarëve, do të rritet niveli i sigurisë ligjore, do të ketë një planifikim më të mirë dhe do të rritet edhe llogaridhënia e proceseve politike.

Nga ana tjetër, analizat e organizatës "Analitika" tregojnë se në këtë periudhë, kur qeveritë janë të ballafaquara me sasi të mëdha rregullativash, është përtej pyetjes se regullativa duhet në mënyrë imperative t'u jepet një trajtim dhe konsideratë e veçantë. Roli i aktorëve politik duhet të konsistojë në të siguruarit që rregullativa në fuqi plotëson kriteret e një rregullative efikase dhe garanci që ajo prodhon efekte pozitive në drejtim të palëve të interesuara ose më gjerë ndaj të gjithë qytetarëve. Me fjalë të tjera, mekanizma për të parashikuar ndikimet e politikës së propozuar, të tilla si Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR), duhet të vihen më fuqishëm në praktikë.

Shtetet më të zhvilluara të botës apo vendet e OECD - SHBA-të dhe Australia, kanë aplikuar rregullisht VNR si mbi politikat e reja, ashtu edhe mbi ato ekzistuese me dekada të tëra. Që nga viti 1974 kur u bë prezantimi i parë i VNR, VNR ka shënuar vazhdimisht rritje të padiskutueshme popullariteti, duke u bërë një element përbërës në proceset e politikë-bërjes së vendeve të përmendura më lart. Nga ana tjetër në Maqedoninë me më pak apo më shumë sukses një praktikë e tillë zbatohet prej vitit 2009. Për këtë qëllim në funksion është edhe ENER, apo Regjistri unik kombëtar elektronik i ligjeve në Maqedoninë e Veriut. Ai paraqet një vegël kryesisht për informimin elektronik të qytetarëve, OJQ-ve, odave ekonomike dhe zyrtarëve të ndryshëm.

Shitet Monopoli, reagojnë aksionarët

Tetovë, 27 mars - Dhjetëra punëtorë të "Tetova - Tabaku", i njohur si ish Monopoli, sot nëpërmjet një proteste paqësore kanë shprehur pakënaqësinë e tyre pas informacioneve të marra se toka, objekti dhe e gjitha firma i është shitur një investitori privat pa u informuar aspak, dhe pa kurrfarë kompensimi për pagat dhe aksionet, të cilat ata i kishin në këtë kompani. Sipas Darko Gjorgjeskit, prona e Shoqërisë Aksionare "Tetovo Tabak" në likuidim është shitur me një marrëveshje paraprake, si pronë e shtetit pa u marrë parasysh 11 për qind e aksioneve të cilat i kanë poseduar rreth njëqind aksionarë të regjistruar në librin e aksionarëve. Gjorgjeski së bashku me aksionarët tjerë dyshojnë se me marrëveshjen paraprake me investitorin privat po mundohen që të manipulojnë aksionarët e Tetova Tabak-ut, mes të cilëve më të prekur janë punëtorët, të cilëve nuk ua kanë paguar pagat për rreth 4 vite. "Monopoli është shitur në rrethana të dyshimta. E tërë prona ka kaluar në emër të shtetit dhe është shitur përmes një para-kontrate, që është manipulim me aksionarët. Me këtë humbin edhe aksionet edhe rrogat tona. Si mund dikush të shet pronën pa na pyetur neve. Në Regjistrin qendror neve më nuk kemi aksione, na i kanë fshirë, na thanë se kjo është bë meqë firma ka shkuar në falimentim, por pa asnjë njoftim tonin paraprak", theksoi Darko Gjeorgjievski, aksionar i "Tetova-Tabaku". Ai nënvizoi se asetet e kompanisë u transferuan në emrin e vendit dhe u shitën në kohën e fundit për një sipërmarrës privat nga ana e tre likuiduesve, ku sipas marrëveshjes paraprake fillimisht është shitur një pjesë prej 1800 metrave katror për vetëm 5 milionë denarë.

Prona e Monopolit shtrihet në një hapësirë prej rreth 44 mijë metrash katror. Kjo hapësirë është në hyrje të Tetovës nga Shkupi dhe sipas punëtorëve dhe aksionarëve është një vend shumë tërheqës që është me vlerë të madhe. Blerësi i firmës "Tetova-Tabaku" ka thënë se procesi i blerjes është bërë në mënyrë ligjore. Në këtë vend, investitori ka paraparë ndërtimin e objekteve të banimit, ndërsa blerja e ish Monopolit i ka kushtuar 7.5 milion euro. Për shitjen nuk është e informuar as Komuna e Tetovës. *(U.H)*

DEPUTETËT VOTOJNË LIGJET QË NUK I FIRMOSI IVANOVI

EDHE ZYRTARISHT SHUHET SIMO

Për shuarjen e SIMO-s votoi deputeti dhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ndërsa mbështetje mori edhe nga deputetët e VMRO-DPMNE-së

Koha — Zejnulla VESELI

Shkup, 27 mars - Me dy të tretat e votave, deputetët e Parlamentit të Maqedonisë votuan Ligjin për formimin e Ministrisë për Sistem Politik dhe marrëdhënie midis bashkësive dhe propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Me miratimin e Ligjit për formimin e Ministrisë së re, edhe zyrtarisht shuhet Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit (SIMO). Për shuarjen e SIMO-s votoi deputeti dhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ndërsa mbështetje mori edhe nga deputetët e VMRO-DPMNE-së. Gjithashtu në seancën e 94 plenare që përfundoi të mërkurën, dritë jeshile në leximin e dytë deputetët dhanë edhe për pesë ligje që mbajnë flamurin evropian në mesin e te cilëve ishin dhe propozim-ligji për Regjistrin qendror të popullsisë dhe propozim-ligjin për mbrojtje sociale, si dhe u miratuan dhe ligjet e propozuara nga deputetët të partive të shumicës parlamentare.

Ndërkohë, deputetët e miratuan vendimin për dhënien e statutit "Universiteti Nënë Tereza" në Shkup dhe Statutin "Universiteti Shën Klimenti i Ohrit", në Manastir, Ligjin për shërbime, për përmbarim të sanksioneve, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për borxhin publik, Ligjin për regjistrim të parave kesh. Paraprakisht, para se kryetari i Parlamenti, Talat Xhaferi t'i hedh në votim ligjet, fjalë kërkoi deputetja e VMRO-DPMNE-së, Liljana Zaturovska e cila kërkoi nga kryetari i Parlamentit të mos miratohen Ligjet me procedurë të shkurtë e të cilat fshihen pas flamurit evropian.

"Me muaj bëjnë përpjeke që ta parandalojmë praktikën e keqe të LSDM-së, e cila prej se është në pushtet, miraton ligje me procedurë të shkurtër, për të cilat aspak nuk duhet të fshihet pas flamurit evropian. A do të thotë kjo se nuk keni autoritet të mjaftueshëm që t'ju kundërvihemi këtyre vendimeve ligjore që mbajnë flamurin evropian", pyeti deputetja Zaturovska. I menjëhershëm ishte reagimi i kryeparlamentarit Xhaferi, i cili u shpreh se vendosja e ligjeve nuk varet nga vetë ai, por as nga autoriteti i tij.

"Kam autoritet të plotë të udhëheqë me punën e Parlamentit. Procedurat janë të përcaktuara në Rregulloren. Kërkesat e deputetëve dhe institucionet janë kompetent të propozojnë ligje, ndërsa unë kam detyrim të njëjtat t'i hedh në shqyrtim para deputetëve. Për këtë nuk vendos unë, por shumica e deputeteve në Parlament", u përgjigj Xhaferi.

Ndërkohë sa i përket vendosjes në rend dite të 11 ligjeve, të cilët nga muaji janar i këtij viti u miratuan nga shumica e deputetëve, e të cilat ende nuk janë nënshkruar nga presidenti aktual i shtetit Gjorgje Ivanov, në leximin e tretë do të shqyrtohen nga deputetët në seancën e 95 e cila u mbajt në orën e vonshme të pasdites së mërkurë. Në rend dite ishin Ligji për Agjencinë Tekniko Operative (ATO) dhe Ligji për Agjencinë për ndjekjen e komunikimeve. Po ashtu, deputetët në lexim të tretë e shqyrtuan Ligjin për mbrojtje dhe parandalim nga diskriminimi, Ligjin për Kryqin e Kuq, Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë dhe Ligjin për dokumente elektronike.

MSHIA VENDOSI VEGLËN PËR DENONCIME TË ADMINISTRATËS

TË PARAQITEN PRESIONET GJATË KOHËS SË FUSHATËS

Shkup, 27 mars - Të punësuar në Administratën publike prej sot do të mund të paraqesin presion eventual në vendin e punës gjatë fushatës vijuese të zgjedhjeve presidenciale në veglën që ka bërë publike Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA). Paraqitja do të jetë anonime, por nëse dikush dëshiron mund t'i lë të dhënat personale të cilat do të mbrohen konform Ligjit për mbrojtje të të dhënave personale. Këtë sot e ka deklaruar ministri për Shoqëri Informatike dhe Administratë Damjan Mançevski, i cili ka porositur se nuk do të ketë presione, shantazhe dhe keqpërdorime të të punësuarve në administratë publike dhe ka shtuar se Qeveria punon me përkushtim në reformimin e administratës e cila siç tha, "do të jetë profesionale dhe në shërbim të qytetarëve".

"Vendosja e veglës ka për qëllim të shërbejë si mbrojtje të administratë në rast të presioneve. Ata do të mund në një vend të paraqesin keqpërdorime dhe presione. MSHIA këtë e ka bërë edhe gjatë kohës së fushatës së referendumit", ka thënë Mançevski dhe ka shtuar se të gjitha fletëparaqitjet e arritura do të përcillen deri te organet kompetente për veprim të mëtejshëm. Ai ka shtuar se ky është edhe një mekanizmat të cilat MSHIA i ka ndërmarrë për profesionalizim të plotë në administratën publike dhe ka shtuar se poashtu finalizohet edhe ligji për shërbim të lartë udhëheqës, ku janë caktuar kritere të larta dhe standarde për bartësit e pozicioneve të larta. Në pyetjen nëse në koalicionin qeveritar ka ujdi për qëndrimet e zëvendës drejtorëve në institucione dhe Ndërmarrjet publike, Mançevski është përgjigjur se ligji i ri nuk parashikon zëvendës, qe 20 ditë është në Regjistrin e vetëm elektronik kombëtar dhe për të duhet të ketë një debat të gjerë me qëllim të sillet zgjidhja më e mirë e mundshme. Ai ka paralajmëruar debat publik në Kuvend, por edhe debat publik me ekspertë dy muajt e ardhshëm me qëllim në mënyrë më transparente të mbyllen të gjitha çështjet e hapura lidhur me këtë vendim ligjor. Mançevski ka shtuar se nëse gjatë debatit dëshmohet se ekziston nevojë reale zëvendës drejtorët të mbeten në institucione dhe Ndërmarrjet publike, atëherë ekziston mundësia të përfshihet në ligj.

Qytetarët më së paku i besojnë gjyqësisë

Shkup, 27 mars - Qytetarët në vitin 2018 mosbesim më të madh shfaqën ndaj pushtetit gjyqësor, që tregon edhe numrin dyfish të rritur të parashtresave lidhur me jurisprudencën, parashtruar tek Avokati i popullit, tha zëvendësja e Avokatit të popullit, Vaska Bajramovska-Mustafa, duke e prezantuar Raportin vjetor për punën e këtij institucioni. "Vitin e kaluar vepruam rreth 4.482 parashtresave, prej të cilave 3.458 u pranuan në raportin vjetor, me ç'rast 50 u hapën me nismë vetanake për sfera të ndryshme", tha Bajramovska-Mustafa, duke cekur se numri më i madh i parashtresave ishin nga sfera e jurisprudencës, marrëdhënieve të punës, institucionet ndëshkuese përmirësuese, të drejtat konsumatore, mbrojtjes së të drejtave gjatë autorizimit policor, punës financiare, mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, si dhe mbrojtjes sociale dhe shëndetësore. Kohëzgjatja e procedurave, siç theksoi ajo, është problem themelor për të cilin kërkohet mbrojtje, ndërkaq është i madh edhe numri i parashtresave në të cilat qytetarët shprehin pakënaqësi nga vendimet gjyqësore për të cilat konsiderojnë se janë sjellur njëanshëm, në mënyrë selektive, nën presion dhe motivim politik. Në raport është cekur se për rreth 60 për qind është rritur numri i parashtresave të parashtruara lidhur me të drejtat e marrëdhënieve të punës. Me atë rast qytetarët më shpesh kërkojnë mbrojtje për shkak të shkeljes së të drejtave në procedurat për punësim, për sistemimin e të punësuarve, për ndërprerje të marrëdhënies së punës, si dhe procedura rreth ankesave. Theksoi se rritje të vogël ka tek parashtresat për diskriminim në bazë të përkatësisë politike, në baza etnike, si dhe mbrojtje nga mobingu në vendin e punës. Sipas zëvendëses së Avokatit të popullit dukshëm nuk janë përmirësuar as gjendjet në sferën e enteve ndëshkuese-përmirësuese lidhur me kushtet e vendosjes, ushqimit, kushteve higjienike, si dje trajtimi joadekuat stomatologjik i personave në burgje. Theksoi se gjendjet janë alarmante edhe lidhur me të drejtat e fëmijëve, posaçërisht në pjesën e dhunës në shkolla. Krahasuar me vitin 2017, siç theksoi Bajramovska-Mustafa në raport këtë vit vërehet ulje e shkeljeve të konstatuara për 7,60 për qind, ndërsa nga ana tjetër analiza e të dhënave lidhur me rekomandimet e pranuara të Avokatit të popullit tregojnë ulje për 13,42 për qind në krahasim me vitin 2017.

PLAN AKSION I QYTETIT TË SHKUPIT

SHKUPI, PJESË E FAMILJES SË QYTETEVE TË GJELBRA

Shilegov paralajmëroi se Plani aksional do të përpilohet rreth 13 muaj para se të shqyrtohet dhe miratohet në seancën e Këshillit të Qytetit të Shkupit. Sektorët kyç që do të përfshihen nga ky Plan aksional janë qarkullimi, objektet ndërtimore, industria, energjetika, uji, mbeturina të ngurta dhe përdorimi i tokës

Koha — Qefsere ABDYLI

Shkup, 27 mars - Shkupi është qyteti i parë i shtetit që kyçet në rrjetin e qyteteve të gjelbra të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe e fillon edhe përpunimin e Planit aksional të qytetit të gjelbërt. Këtë dje e theksuan pjesëmarrësit në mbledhjen hyrëse dhe seminarin për implementimin e projektit njëvjeçar për mbështetje të zhvillimit të Planit aksional "Shkupi qytet i gjelbër" (Skopje Green City Action Plan - GCAP). Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov informoi se Qyteti i Shkupit dhe BERZH-i fillojnë me përpunimin e Planit aksional "Shkupi qytet i gjelbër". Plani aksional, siç tha duhet t'i ndihmojë Qytetit të Shkupit që t'i identifikojë dhe adresojë sfidat për mjedisin jetësor – mbeturinat e fuqishme dhe reciklimin, ngrohjen qendrore, trajtimin e ujërave të zeza dhe transportin urban me qëllim që të zvogëlohet ndotja lokale, të përmirësohet efikasiteti energjetik dhe efikasiteti i resurseve, si dhe adaptimi i ndryshimeve klimatike.

Ai paralajmëroi se Plani aksional do të përpilohet rreth 13 muaj para se të shqyrtohet dhe miratohet në seancën e Këshillit të Qytetit të Shkupit. Sektorët kyç që do të përfshihen nga ky Plan aksional janë qarkullimi, objektet ndërtimore, industria, energjetika, uji, mbeturina të ngurta dhe përdorimi i tokës. "Qëllimi ynë përfundimtar është që të përpunohet Plani aksional i Qytetit të Shkupit për qytet të gjelbër nga Këshilli dhe për këtë i shfrytëzojmë shërbimet e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe konsulentët që i ka. Një projekt tashmë bashkërisht e punojmë, ky është furnizimi i autobusëve me gaz natyror në vlerë prej 10 milionë eurove. Nga ky Plan aksional duhet të dalin masat që Qyteti do t'i ndërmerr si politika në pesë deri dhjetët vitet e ardhshme", deklaroi Shilegov. Shtoi se është me rëndësi që në fund të marrim dokument dhe krijim të politikave që do të mundësojnë të jetojmë në mjedis më të shëndoshë jetësor nga ajo me të cilën përballemi në dekadën e fundit.

Në takimin hyrës dhe seminarin për implementimin e projektit njëvjeçar për mbështetje të zhvillimit të Planit aksional "Shkupi qytet i gjelbër" (Skopje Green City Action Plan - GCAP) marrin pjesë përfaqësues nga komunat, sektori i biznesit, sektori joqeveritar, nga më shumë institucione, konsulentë... Gjatë ditës është parashikuar edhe seminari i parë me të gjitha palët e prekura të përfshira në projekt. Suzan Goranson, drejtoreshë për infrastrukturë për Evropë, Grupacioni për infrastrukturë të qëndrueshme pranë BERZH-it kumtoi se qëllimi i tyre është që të financojnë deri në 100 qytete të gjelbra dhe të përqendrohen në sfidat me ndryshime klimatike.

BERZH-i do të bashkëpunojë me Qytetin e Shkupit dhe me përfaqësues të institucioneve komunale të këtij projekti me qëllim që t'i identifikojë prioritetet, përmes përcaktimeve paraprakisht të definuara nga ana e Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD) dhe rrjeti global i Qeverive lokale për qëndrueshmëri (ILCEI) që të krijojë plan të aktiviteteve dhe qëllimeve për veprim në dhjetë vitet e ardhshme. Plani do të zhvillohet gjatë këtij viti, para se parashtrohet për miratim para Këshillit të Qytetit të Shkupit. Deri më tani BERZH ka investuar mbi 1.85 miliardë euro në vendin tonë në 115 projekte, nga të cilët pjesa më e madhe janë në sektorin e infrastrukturës.

Tetë milionë euro për rrugën Gostivar-Kërçovë

Kërçovë, 27 mars - Rreth tetë milionë euro investojmë në rekonstruimin e aksit rrugor nga Gostivari deri në Kërçovë. Rekonstruimi i kësaj rruge është prioritet i yni sepse është me rëndësi të madhe për këtë pjesë të shtetit duke pasur parasysh se në nivel vjetor kalojnë mbi katër milionë automjete, deklaroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve Goran Sugareski nga Kërçova.

"Gjithsej tetë milionë euro investohen përmes NP për rrugë shtetërore për rekonstruimin e aksit rrugor nga Gostivari deri në Kërçovë. E rekonstruuam rrugën nga Gostivari deri në Kolari dhe në mënyrë shtesë edhe pesë ura. Në tetor të këtij viti filluam edhe me rekonstruimin e kësaj rruge nga Kollari deri në Kërçovë, por për shkak të kushteve të motit kishte vonesa të vogla. Ka filluar asfaltimi intensiv dhe presim që i gjithë projekti të përfundojë deri në fund të qershorit që të mundet që para fillimit të sezonit të mundësojmë vozitje më të mirë në këtë trase", deklaroi Sugareski, i cili pret realizim të madh të investimeve kapitale këtë vit. Sipas ministrit, në mënyrë aktive punohet edhe në ndërtimin e autostradës Kërçovë – Ohër, ndërsa këtë vit pritet që NP për rrugë shtetërore të përfundojë me projektimin e fazës së parë nga Kërçova deri në Bukojçani për ndërtimin e autostradës Gostivar-Kërçovë. "Në përgjithësi fuqishëm jemi të përqendruar për sigurimin e rrjetit cilësor të infrastrukturës gjithkund përgjatë shtetit dhe për atë realizohen përmes një miliardë investimeve", theksoi Sugareski.

Përfundon ndërtimi i trotuareve afër stadiumit në Tetovë

Tetovë, 27 mars - Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi me bashkëpunëtorët, dje kreu kontroll në punët e ndërtimit të trotuareve në të dy anët e rrugës "Bllagoja Toska" afër stadiumit të vjetër. Kjo rrugë mundëson lidhjen e qytetit me rrugën rajonale që çon drejt vendkalimit kufitar "Jazhincë" dhe ku ka numër më të madh të fshatrave për ç'shkak komunikacioni është intensiv pothuajse gjatë tërë ditës. "Në vendin e ngjarjes dëshirojmë të bindemi se si rrjedhin punët për ndërtimin e trotuareve në këtë pejsë të rrugës 'Bllagoja Toska" afër stadiumit të vjetër të qytetit. Kjo pjesë ishte asfaltuar para një viti e gjysmë dhe tani tërësisht do të kompletohet me trotuare nga të dyja anët e rrugës. Bëhet fjalë për rreth 750 metra trotuare, ndërsa tashmë ka përfunduar instalacioni nëntokësor. si dhe ndriçimi, me çka do të mundësohet lëvizje më e lehtë edhe e automjeteve edhe e këmbësorëve në këtë pjesë të qytetit", tha Arifi. Ajo theksoi se njëkohësisht me këtë ndërhyrje po punohet në përfundimin e trotuareve edhe afër shkollës së tekstilit dhe rrugës "Murat Baftijari" përderisa në periudhën në vijim, në pajtim me planet e institucioneve kompetente komunale do të ndërmerren aktivitet për ndërtimin dhe riparimin e trotuareve edhe në vende të tjera në qytet. *(U.H)*

AKOMA PA NIS ME PUNË ANSAMBLI SHTETËROR I KËNGËVE DHE VALLEVE SHQIPE

Shkarkohet Lumani, emërohet Pustina

Shkup, 27 mars - Akoma pa nis me punë Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Shqipe, është shkarkuar drejtori Fatos Lumani, ndërsa menjëherë në vend të tij është emëruar Jeton Pustina. Lajmin për emërimin e drejtorit të ri e ka bërë të ditur sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri, ndërsa në profilin e tij në Fejsbuk ka shkruar se Aziri i "dëshiron z.Puëstina një fillim të mbarë në punën e re në këtë Institucion që shënon hap të rëndësishëm për kulturën tonë shqiptare duke kultivuar dhe ruajtur vlerat dhe traditat e mirëfillta të kombit shqiptarë".

Po në Fejsbuk, ish-drejtori tashmë, Fatos Lumani, ka shkruar se ka ofruar dorëheqjen e tij, me qëllim që, siç shkruan ai, " të shkurtoj procedurat e shkarkimit tim".

"Duke marrë shkas nga një iniciativë të mbërrirë në Ministrinë e Kulturës nga subjekti politik të cilit i takon posti i Ansamblit Shtetëror Shqiptar, Ministria e Kulturës së RMV-së, ka marrë iniciativë për shkarkimin tim nga posti i drejtorit të Ansamblit Shtetëror Shqiptar. Duke dashur të shkurtoj procedurat e shkarkimit tim, jap dorëheqje nga ky post", shkruan Lumani, ndërsa ka renditur disa nga punët të cilat janë realizuar në mandatin e tij një vjeçar. Ndryshe, Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Shqipe akoma nuk ka një seli të veten, ndërsa deri tani, ishin caktuar dytre hapësira, por që asnjëra nuk ishin të denja për zhvillimin e aktiviteteve të këtij ansambli.

A MUND TË SJELLË NDRYSHIME VALA E PROTESTAVE NË BALLKAN?

Ndonëse motivet e shumicës së protestuesve janë të qarta dhe vendimtare, kjo nuk garanton ndryshime drejt së mirës. Maqedonia e Veriut, e cila pas demonstratave disamujore ushtroi presion ndaj Qeverisë së saj për zgjidhjen e kontestit afatgjatë për emrin me Greqinë, paraqet shembull premtues dhe frymëzues. Por, një mbikëqyrje më realiste do ta kishte përshkruar Maqedoninë e Veriut si përjashtim në rajon

Fundjava e kaluar është shënuar me edhe një valë protestash antiqeveritare në Serbi, Mal të Zi dhe në Shqipëri, ku me dhjetëra mijëra njerëz dolën në rrugë. Kështu fillon analiza e Vasko Garçeviç, profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë në Universitetin e Bostonit, në uebfaqen „The Globe Post“ për protestat që i kanë përfshirë vendet ballkanike në muajt dhe javët e fundit.

Duke protestuar kundër pushtetit autoritar, korrupsionit të elitës në pushtet, që është karakteristikë e rajonit, partikratisë dhe situatës së përkeqësuar ekonomike, serbët demonstrojnë me muaj të tërë, derisa në Mal të Zi dhe në Shqipëri protestuesit janë në rrugë vetëm disa javë. Ndonëse shumica e protestuesve në tri shtetet ballkanike e tregojnë pakënaqësinë e tyre në rritje ndaj atyre që janë në pushtet dhe tregojnë dëshirë të fuqishme për ndryshim të përgjithshëm, demonstratat nuk mund të vihen me një emërues të përbashkët.

Trazirat qytetare filluan në Republikën Sërpska, zonën autonome serbe në Bosnjë e Hercegovinë. Rasti me nxënësin që ndërroi jetë pas brutalitetit të mundshëm policor shkaktoi pakënaqësi te njerëzit. Pas disa javësh, autoritetet ndaluan protestat dhe arrestuan organizatorët. Në Shqipëri, trazirat i organizon partia opozitare, agjenda ditore politike e së cilës është të bëjë thirrje për zgjedhje të reja dhe të sjellë partinë e saj në pushtet. Në Serbi, mitingjet antiqeveritare të shkaktuara nga rrahja e liderit të opozitës janë përzierje e aktivizmit civil dhe inxhinieringut politik. Ndërkohë, në Mal të Zi, mosdëgjueshmëria qytetare është nxitur nga skandalet korruptuese në të cilat ishin përfshirë funksionarë të lartë të partisë në pushtet.

Protestat janë të qeta dhe grupet civile, së paku deri tani, e mbajnë anash opozitën me prirje nacionaliste.

URIA PËR REFORMA DEMOKRATIKE

Ndonëse motivet e shumicës së protestuesve janë të qarta dhe vendimtare, kjo nuk garanton ndryshime drejt së mirës. Maqedonia e Veriut, e cila pas demonstratave disamujore ushtroi presion ndaj Qeverisë së saj për zgjidhjen e kontestit afatgjatë për emrin me Greqinë, paraqet shembull premtues dhe frymëzues. Por, një mbikëqyrje më realiste do ta kishte përshkruar Maqedoninë e Veriut si përjashtim në rajon. Nga ana tjetër, ndryshimi i pushtetit nuk është e thënë të shpie drejt përgjegjësisë më të madhe. Serbia është dëshmi për këtë, si edhe Shqipëria, ku as Partia Socialdemokrate e cila është në pushtet, as Partia Demokratike opozitare nuk e arritën atë që e duan qytetarët: reforma efektive demokratike.

Mali i Zi, ku një parti politike është në pushtet me dekada të tëra, shpesh paraqitet si partikrati, ku kufiri mes shtetit dhe partisë në pushtet është i paqartë. Njëherësh, vendi arriti përparim në procesin e aderimit në BE dhe u lëvdua në Bruksel si udhëheqës rajonal. Megjithatë, kjo më shumë është e ndërlidhur me (pa)aftësinë e pjesës së mbetur të rajonit që të reformohet, sesa me përparimin evident në Mal të Zi.

ROLI I PARTIVE OPOZITARE

Ato që janë në pushtet mbajnë përgjegjësinë më të madhe për reformat sociale, por nuk janë arsyeja e vetme për zhvillimin e ngadalshëm të demokracisë. Një pasqyrë të partive opozitare në Serbi dhe në Mal të Zi hapë çështje për potencialin e tyre demokratik. Profili politik i "Aleanca për Serbinë", që ekzistojnë prapa protestave në vend, është i paqartë. Kjo është përzierje e disa partive të matura politike, që përbëjnë një minoritet të qetë. Manifesti politik i Aleancës është premtues në disa marrëdhënie, meqë insiston në demokraci, media të lira dhe zgjedhje të lira. Ai, megjithatë, është shumë i paqartë kur bëhet fjalë për anëtarësimin e Serbisë në BE, si dhe për bashkëpunimin me Moskën dhe politikën rajonale. Në raport me Kosovën, Aleanca është më e ngurtë sesa Qeveria aktuale. Është brengosës fakti që në "Aleancën për Serbi" është edhe lëvizja ekstreme djathtiste, shoviniste "Dveri", e cila parakalon me pozicione antievropiane, ortodokse-konservative. Mali i Zi ofron pak a shumë pasqyrë të njëjtë me disa nuanca të reja pozitive.

Njëra prej partive më të mëdha opozitare, Fronti Demokratik, i cili konsiderohet aleat kyç i Kremlinit në vend, ngushëllohet me protestat e vazhdueshme në Mal të Zi, por u kundërvihet ngjarjeve të ngjashme me ato në Serbinë fqinje. Njëri prej liderëve të Frontit para do kohë iu bashkëngjit "Lëvizjes" anti BE të Stiv Banonit. Asnjëri prej liderëve opozitarë nga Mali i Zi ose nga Serbia nuk e dënoi publikisht tubimin e paradokohshëm të ithtarëve të veshur me të zeza të lëvizjes ultranacionaliste çetnike serbe. Në mitingun në Vishegrad, Bosnjë e Hercegovinë, këta nacionalistë e kënduan "lumi Drina sërish do të përgjaket". Drina e paraqet kufirin mes Serbisë dhe Bosnjës, ndërsa Vishegradi është vendi ku në vitin 1992 ishin vrarë myslimanët, në fillim të luftës në Bosnjë.

Në rajonin që vuante nga konflikti i përgjakshëm ndëretnik, secili grup politik që dëshiron të jetojë sipas profilit të tij të proklamuar civil dhe promovon tolerancë duhet doemos të distancohet nga ithtarët e urrejtjes dhe dhunës etnike.

JO PRANVERËS BALLKANIKE

Pjesëmarrësi kryesor i jashtëm - Bashkimi Evropian - është joaktiv dhe nuk dëshiron të ndalet prapa protestuesve. "Jo, pranverës ballkanike" ishte njëri prej reagimeve të para të Brukselit ndaj protestave. Në kulmin e sagës Bregzit, disa muaj para zgjedhjeve evropiane dhe të ngarkuar me populizmin dhe nacionalizmin personal, gjëja e fundit që Brukseli e dëshiron është paqëndrueshmëri e Ballkanit. Shmangia e konflikteve me BE-në rrallë i mbështetë format jashtëinstitucionale të luftës politike, ndërsa sot - më shumë se kurdoherë më parë. Moska, aktori tjetër i jashtëm, i ndjekë me kujdes zhvillimet, duke i mbështetur lojtarët e saj në këtë lojë. Në Serbi ata nuk kanë se çfarë të humbasin, derisa në Mal të Zi kanë potencial për përfitim të madh. Pas demonstratave disamujore, shtrohet pyetja logjike: çfarë tutje? Protestat mund të radikalizohen lehtë, siç ndodhi javën e kaluar në Serbi dhe në Shqipëri. Protestat mund të rrëmbehen nga opozita nacionaliste, gjë që do ta bënte të lumtur Kremlinin. Asnjëra nga ato që përmendëm më sipër nuk është recetë për sukses.

Përveç Shqipërisë, ku ekziston mundësia për zgjedhje të parakohshme në horizont, ka pak shenja se kërkesa ambicioze politike të protestuesve do të merren parasysh. Qeveritë në rajon konsiderojnë se koha është aleati i tyre më i fuqishëm. Pa qenë nën presion, ata besojnë se energjia e rrugës do të shuhet. Ja, prandaj Ballkani përjeton vazhdimisht një formë të ngjashme. Në çdo periudhë prej disa viteve qytetarët dalin në rrugë për të shprehur pakënaqësinë e tyre nga politikanët e korruptuar, por pas një kohe të caktuar energjia zhduket dhe vendet u kthehen skemave të vjetra. Në një ekuacion të këtillë politik, për të marrë biletë për udhëtim demokratik, duhet që Brukseli të jetë në anën tuaj. Megjithatë, fitohet përshtypje se BE-ja nuk është e gatshme ose thjeshtë ka prioritete të tjera.

(BGNES, Sofje)

NATO

Nga
Nazim RASHIDI

20 vjet nuk janë edhe aq shumë në histori, por për jetën e një njeriu mund të bëjnë një dallim të madh. Dhe 20 vjet më parë, as që imagjinohej ajo çka shënojmë sot. Më kujtohet qartazi, në një kohë totale amullie dhe pasigurie, se si nën qiell ngrinim kokat për të parë avionët e NATO-s që ishin nisur drejtë Serbisë. Një ditë e ngjashme me diell, ishte kur një avion çante qiellin dhe kur nga frika e tmerret e luftës, vinte shpresa.

Luftërat mua më kishin ndjekur në periudhat e pas adoleshencës. Ajo e ish Jugosllavisë, pastaj trazirat e 1997 në Shqipëri dhe tani sërish një dyndje dhe një amulli e madhe më 1999 me Kosovën. E gjithë bota kishte sytë në Ballkan, kurse mua personalisht do të më duhej të lija Maqedoninë. Pas rreth dhjetë ditë të fillimit të sulmeve ajrore, të cilat filluan më 25 mars, më 3 prill 1999 u nisa për në Londër, ku do të filloja punën time pranë seksionit shqip të BBC-së. Sihariqe i konsideroja edhe sulmet ajrore edhe shkuarjen time në Britaninë e Madhe.

Por shoku i madh për mua ishte se Kosovën e lashë pas dhe Kosovën e gjeta në lajme, në faqet e para të gazetës, në BBC, në rrugë, madje dhe në protesta, kudo... Më kujtohet qartë, se kur shkoja rrugës për në aeroport, i shoqëruar nga familja dhe ende me dilemën e madhe nëse fluturimi për në Londër do të ndodhte ose jo, për shkak të avionëve luftarak që kalonin mbi Shkup, se si shikoja kolona me autobusë e refugjatë. Dhjetëra autobusë që shkonin në drejtime të kundërta, nëpër qytetet shqiptare, ku refugjatët do të strehoheshin. Nuk ma merrte mendja se një shqetësim dhe një vëmendje aq të madhe kishte dhe në Britani për Kosovën.

Por pse? Nuk e gjeja këtë përgjigje menjëherë, në fakt nuk e kuptoja as nga bisedat dhe shpjegimet e kolegëve apo edhe teksteve të gazetës se pse një britanik do të dalë të protestojë për Kosovën, për shqiptarët, për padrejtësinë. Vetëm më vonë më ra në kokë pesha e besimit në një bindje a ideologji, e cila mund të ishte aq e fuqishme dhe të nxiste një britanik që të shqetësohet aq shumë për fatin e ca shqiptarëve atje përtej detërave, siç i thonë ata. Në fakt dhe kjo është esenca për mua sot se pse duhet shënuar dhe folur për sulmet e NATO-s ndaj një regjimi. Nga konteksti historik sulmi ndaj Serbisë ishte krijimi i një rendi të ri global. Aleatë "tradicional" siç thuhej kishin ndryshuar anë. Shqiptarët, viktima,(i) kishin marrë në krahë forcat më të fuqishme.

Sot pas 20 vjetësh, siç e do rasti, të tërë, edhe ata që lajthitën me bindjet dhe interesat, edhe ata që hëngrën çorbë të prishur, e vjellin e ende s'janë shëruar, janë gojë plot me NATO-n, por kjo nuk do mjaftojë. Sepse (tek) besimi i fuqishëm në vlerat e vendeve që çuan deri te NATO i vitit 1999, tek liria dhe esenca e saj, tek respekti dhe dinjiteti i tjetrit, qëndron esenca e shënimit të këtyre sulmeve

Figurat potente të kohës justifikonin sulmet, në emër të shqiptarëve. Padrejtësitë e bëra ndër vite, të dëgjuara në këngë, libra a oda burrash, po përmirësoheshin. Por, sërish dhe sërish, vinte pyetja pse? Pse kjo pjesë e botës ndryshoi mendje? Përgjigjja që se gjeja dot më herët më erdhi më vonë:

Ishte tek besimi i vlerave, ndërtimi i një shoqërie të hapur e cila mësohet që në vegjëli të kujdeset jo veç për vete, por edhe për botën.

Përgjigjja ishte tek përqafimi, me plot bindje të koncepteve filozofike e politike të barazisë, të dinjitetit, të respektit të tjetrit, të të drejtave bazike njerëzore. Të gjitha këto i kisha lexuar më herët, edhe konventat edhe ligjet, por në realitetin në të cilin unë isha rritur, as që bëhej fjalë se respektoheshin. Dhe me këtë realitet në krye, as që mendoja se edhe të tjerët mund të kishin pasionin dhe vrullin për të protestuar e mbrojtur të drejtat e dikujt tjetër, atje, aq larg tyre. Më goditi kjo vetëdije si grusht në kraharor, se sa të privuar si shoqëri kishim qenë, për të parë e jetuar me dinjitetin e të qenit i lirë.

Ishte kjo frymë dhe shkelja e këty-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë, 27 mars 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

re parimeve që i bënte me mijëra njerëz të dalin e të protestojnë, e të bëjnë presion që të sulmohet regjimi i Milosheviçit. Dhe këtë e kam parë vetë, por më pas e shikoja edhe për Ruandën, një gjenocid tjetër i tmerrshëm, apo dhe për vende dhe regjime të tjera. Pra ajo botë perëndimore, ajo e vendeve aleate, siç ishte Britania e Madhe, protestonte edhe për të tjerë, edhe më përtej detërash, edhe më përtej nesh.

Sot pas 20 vjetësh jemi në një kontekst tjetër global. Të tjerë liderë e të tjera vlera ofrohen. Ka një lëkundje serioze ndaj besimit dhe vlerave liberale e të hapura. Ka një sfidë serioze ndaj tolerancës dhe respektit për tjetrin. Po rritet lehtësia e akuzave dhe denigrimit të tjetrit mbi çfarë do lloj baze. Por kjo nuk është bota, e madhja, por edhe ajo që mua më rrethon, të cilën dua ta shoh e jetoj. Dhe në kulmin e kësaj krize të vlerave që gëzojnë esencën e njeriut dhe njerzillëkut, ndodhi një tragjedi tjetër ajo e Zelandës së re. Një bombë tjetër dhe goditje tjetër e madhe për vlerat që unë e shumë të tjerë përfaqësojnë, ku njerëzimi dështon e ku urrejtja dhe dhimbja pastaj nxisin ndarjet dhe paragjykimet.

Por në kulmin e atij pikëllimi e dhimbjeje, ngadhënjeu akti njerëzor dhe vlerat e barazisë të artikuluara jo vetëm nga kryeministrja e Zelandës së Re, por edhe vetë njerëzve. Shamitë në kokë të jo myslimanëve dhe heshtja dhe lotët gjatë lutjes të së premtes ishin shpërthimi i atyre vlerave që i respektoj e dua, e që po sfidohen aq rëndë. Pas 20 vjetësh me këto veprime në Zelandë të re, mund të lidhim pasionin dhe reagimin e kohës për sulmet ndaj Serbisë dhe regjimit atje. Prandaj, 20 vjet më pas Kosova, nuk është më veç një dhimbje më pak në historinë dhe tragjedinë e Ballkanit, por është një peshë më shumë për një brez të tërë, por dhe për ata që vinë, se cilat vlera dhe çfarë fryme të përfaqësojnë e përqafojnë. Sot pas 20 vjetësh, siç e do rasti, të tërë, edhe ata që lajthitën me bindjet dhe interesat, edhe ata që hëngrën çorbë të prishur, e vjellin e ende e s'janë shëruar, janë gojë plot me NATO-n, por kjo nuk do mjaftojë. Sepse tek besimi i fuqishëm në vlerat e vendeve që çuan deri te NATO i vitit 1999, tek liria dhe esenca e saj, tek respekti dhe dinjiteti i tjetrit, qëndron esenca e shënimit të këtyre sulmeve.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Fundi i paqes së Fuqive të Mëdha

Nga
HAL BRANDS & CHARLES EDEL

Në vitin 2010, Barak Obama mund të vëzhgonte një peizazh strategjik, ku "fuqitë kryesore janë në paqe". Megjithatë, nëse sot nuk është rikthyer lufta mes fuqive të mëdha, epoka e paqes mes tyre ka përfunduar. Marrëdhëniet midis shteteve më të forta në botë, po diktohen gjithnjë e më shumë nga rivaliteti i padiskutueshëm dhe madje edhe nga konflikti.

Ka një etje gjithnjë e më madhe për pushtet dhe kontestim, një kontestim gjithnjë e më të madh, të normave dhe parimeve globale. Nga Azia Lindore në Lindjen e Mesme dhe Europën Lindore, aktorët autoritarë po testojnë periferitë e pambrojtura të fuqisë amerikane, dhe po kërkojnë të rivendosin sferat e tyre të privilegjuara të dominimit rajonal. Duke vepruar kështu, ata po e vënë sistemin nën presion, njëherazi në të gjitha frontet kryesore gjeografike. Kina është në ballë të kësaj lëvizje. Ndonëse Pekini, ka qenë një nga përfituesit kryesorë të një rendi ekonomik liberal, gjë që i mundësoi arritjen e një prosperiteti të madh, udhëheqësit kinezë e kanë konsideruar përherë udhëheqësinë amerikane, si diçka që do të durohej për një farë kohe dhe jo përgjithmonë.

Ndërsa fuqia e Kinës është rritur, Pekini është përpjekur të dominojë Azinë e Paqësorit. Politika ka ndjekur retorikën. Për të zbehur pozitat e SHBA-së, Pekini ka provokuar anijet dhe avionët amerikane, që operojnë në ujërat dhe hapësirën ajrore ndërkombëtare. Kina ka sulmuar njëkohësisht besueshmërinë e garancive të aleancës amerikane, duke përdorur strategjitë e saj, siç është ndërtimin e ishullit artificial në Detin e Kinës Jugore, strategji që synojnë të ndryshojnë statuskuonë në rajon. Forcat e saj ushtarake dhe paramilitare, kanë provokuar apo shkelur sovranitetin e vendeve nga Vietnami në Filipine, deri në Indi. Në rrafshin ekonomik, Pekini i përdor "muskujt" e tij për të shpërblyer ata që sillen në përputhje me politikat e saj, dhe për të ndëshkuar të tjetër që nuk e bëjnë këtë. Për habi, Kina ka braktisur parimin e saj të përhershëm të mosndërhyrjes në politikat e brendshme të vendeve të tjera.

Ajo ka zgjeruar propagandën e vet duke përdorur investimet, madje edhe ryshfetet për të bashkuar rreth vetes elitat rajonale. Duke përzier kërcënimet me joshjen monetare, Pekini po synon

> **Revizionizmi gjeopolitik nga fuqitë e mëdha të pakënaqura, ka sjellë shumë shpesh intensifikimin e konfliktit ndërkombëtar, konfrontimit, dhe madje edhe luftës. Sjellja e fuqive të mëdha që po ndodh sot, përfaqëson sinjalin paralajmërues. Ajo na tregon se përpara mund të kemi ngjarje edhe më të rënda**

të ndërtojë një rend rajonal që sillet rreth saj, një sistem të ri kinez për shekullin XX-të. Nëse Kina përfaqëson sfidën më të madhe afatgjatë, ndaj sistemit të udhëhequr nga amerikanët, ringjallja e konkurrencës së fuqisë së madhe, është akoma më akute në Evropë. Për shumë rusë, epoka e pas Luftës së Ftohtë nuk ishte një kohë e triumfit dhe qetësisë. Përkundrazi, ishte një epokë e dobësisë dhe poshtërimit, një periudhë kur Rusia humbi statusin e saj të fuqishëm, dhe ishte e pafuqishme për t'i rezistuar shtrirjes së ndikimit amerikan dhe perëndimor.

Ndërsa ka rifituar një farë force, Moska po synon të rivendosë lidershipin e saj përgjatë periferisë, dhe të rikthejë ndikimin e humbur në vendet e tjera, shpesh përmes masave më pak elegante, dhe shumë më agresive se sa ato të Kinës. Rusia ka provokuar dy herë Perëndimin, duke sulmuar dhe copëtuar Gjeorgjinë dhe Ukrainën, ish-republikat sovjetike që kryen "mëkatin" e animit nga Perëndimi, apo për shkak se rrëzuan nga pushteti udhëheqësit pro-rusë. Në këtë kuadër, Rusia ka punuar gjithashtu për të dobësuar institucionet që garantojnë sigurinë evropiane.

Kremlini ka synuar të minojë NATO-n dhe Bashkimin Europian nëpërmjet sulmeve kibernetike, kërcënimeve ushtarake, dhe subversioneve paraushtarake, mbështetjes financiare për politikanët anti-BE dhe anti-NATO, dhe përhapjes së lajmeve të rreme, si dhe formave të tjera të ndërhyrjes në proceset politike evropiane dhe amerikane. Në vitin 2013, shefi i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë ruse, Valeri Gerasimov, i përshkroi taktika të tilla si "luftëra të reja gjeneruese". Njëkohësisht, Rusia ka përdorur eksportet e energjisë për t'i mbajtur të varura ekonomikisht shtetet në periferi të saj, dhe ka eksportuar korrupsionin dhe anti-liberalizmin në shtetet e ish-zonës së Paktit të Varshavës dhe Azisë Qendrore, për të parandaluar depërtimin e mëtejshëm të vlerave liberale.

Udhëheqësit rusë, kanë kërkuar shprehimisht shfaqjen e një "rendi botëror post-Perëndimor". Më së fundi, revisionizmi gjeopolitik është i fortë në Lindjen e Mesme. Irani, autori kryesor i këtij revizionizmi, nuk ka të njëjtën fuqi si Kina apo Rusia. Por, është një qytetërim krenar, që nuk ka pranuar kurrë një rend në Lindjen e Mesme të udhëhequr nga Uashingtoni, dhe është një shtet revolucionar, që ka synuar me kohë të eksportojë ideologjinë dhe ndikimin e saj. Irani e ka përdorur luftën civile siriane, dhe milicitë Huhit në Jemen për të destabilizuar rajonin, çka ka rritur vazhdimisht shanset për një luftë të hapur, që mund të marrë lehtësisht dimensione rajonale. Secila nga këto sfida gjeopolitike është e ndryshme, dhe secila reflekton interesat, ambicjet dhe historinë dalluese të vendit që i ndërmerr ato. Megjithatë, ekziston një bashkëpunim në rritje midis vendeve që po sfidojnë shtyllat rajonale të rendit të udhëhequr nga SHBA.

Rusia dhe Kina kanë bashkëpunuar në çështje të tilla si energjia, shitja dhe zhvillimi i teknologjisë ushtarake, kundërshtimi i vendosjeve ushtarake të Shteteve të Bashkuara në gadishullin Korean, dhe stërvitjet detare nga Deti i Kinës Jugore në Baltik. Në Siri, Irani siguroi trupat që ndihmuan qëndrimin në pushtet të aleatit të Rusisë, Bashar Al-Assad, teksa Moska siguroi fuqinë ajrore dhe mbulimin diplomatik. "Bashkëpunimi ynë, mund të izolojë Amerikën", i tha Putinit, udhëheqësi suprem Ali Khamenei në vitin 2017. Rigjallërimi i konkurrencës mes fuqive të mëdha, përfshin tensionet më të larta ndërkombëtare që bota ka njohur ndër dekada. Bota nuk është rikthyer ende tek përplasjet epike për dominim global që karakterizoi shekullin XX-të, por është rikthyer në normën historike të luftës së fuqisë së madhe.

Historikisht, ky ka qenë një model i përsëritur i sjelljes së fuqisë së madhe, interesat zgjerohen me forcë, oreksi rritet duke ngrënë, ndërsa llogariten kostot e hershme që duhen paguar. Ky model, është pikërisht arsyeja pse ringjallja e konkurrencës së fuqisë së madhe, është aq shqetësuese. Sepse revizionizmi gjeopolitik nga fuqitë e mëdha të pakënaqura, ka sjellë shumë shpesh intensifikimin e konfliktit ndërkombëtar, konfrontimit, dhe madje edhe luftës. Sjellja e fuqive të mëdha që po ndodh sot, përfaqëson sinjalin paralajmërues. Ajo na tregon se përpara mund të kemi ngjarje edhe më të rënda. *(National Interest)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

NJERËZIT QË VONOHEN JANË MË TË SUKSESSHËM DHE MË KREATIVË

Kultura të ndryshme kanë kuptime të ndryshme për kohën, por veçanërisht në botën perëndimore të qenët vonë konsiderohet si diçka e pasjellshme dhe joprofesionale

Shkenca u del në mbrojtje personave që vonohen duke argumentuar se ata kanë më shumë gjëra në mendje, janë më kreativë, të suksesshëm dhe se e shohin botën ndryshe.

Ne të gjithë kemi një mik apo koleg i cili nuk vjen kurrë në orar. Ata nuk e bëjnë këtë për të na zemëruar neve apo sepse mendojnë se kanë të drejtën të vonohen, kjo ndodh për shkak se është në natyrën e tyre. Ndërsa menaxhimi me sukses i kohës mund të jetë i lehtë për disa, të tjerë nuk arrijnë kurrë të mësojnë artin e planifikimit dhe vendosjes së prioriteteve. Nëse nuk jeni një nga këta persona që vonohen, atëherë jeni të prirur të zemërohemi nga njerëzit që nuk vijnë në orar. Mungesa e korrektësisë nuk pëlqehet në të gjithë botën, e veçanërisht kur bëhet fjalë për punën.

Kultura të ndryshme kanë kuptime të ndryshme për kohën, por veçanërisht në botën perëndimore të qenët vonë konsiderohet si diçka e pasjellshme dhe joprofesionale.

VONESAT NUK JANË MOSRESPEKTIM

Ne duhet të ndalojmë së bëri të ndihen keq njerëzit që vonohen. Ata nuk janë aspak përtacë, kjo mund të nënkuptojë se ata kanë shumë për të bërë. Kur merreni me disa gjëra njëherësh , ju humbisni sensin e kohës. Sigurisht, disa studime ngrenë pikëpyetje mbi efikasitetin e bërjes së disa gjërave njëkohësisht, por veçanërisht njerëzit e suksesshëm priren të bëjnë më shumë se një gjë në të njëjtën kohë. Mendoni për aktorin e kthyer në sipërmarrës, Ashton Kutcher për shembull, i cili është një producent, drejton një kompani virtuale të medias dhe ka interes për kompanitë teknologjike si Skype, Sportify, Uber dhe Foursquare - ndërkohë që mbetet një nga aktorët më të suksesshëm të momentit.

ATA QË VONOHEN JANË OPTIMISTË

Nëse vini re se jeni vazhdimisht vonë, kjo mund të ndodhë për shkak se jeni optimist. Po, pikërisht kështu! Nëse jeni një optimist, prireni të mendoni se keni më shumë kohë në duart tuaja nga sa keni realisht. Ka kuptim, apo jo? Ky lloj të menduarit pozitiv është i njëjti tipar personaliteti që ju bën më të suksesshëm në jetë: një studim mes agjentëve të shitjes tregon se optimistët priren të shesin 88% më shumë se kolegët e tjerë.

Por ka edhe më shumë se kaq. Optimizmi, i cili është tipari i personalitetit tuaj përgjegjës për vonesën, ju bën të jetoni më gjatë. Nëse e kaloni jetën me një sjellje pozitive, zemra juaj do t'ju falënderojë për faktin se nuk e keni vënë nën presion. Për ta përmbledhur: nuk është faji juaj pse vonoheni. Ju e perceptoni botën më ndryshe se sa të tjerët përreth jush. Herën tjetër që dikush do t'ju kritikojë për vonesën, tregojani këtë artikull.



Apple do të vijë me kartë krediti, ja ku mund ta gjeni

Apple ka njoftuar se do të sjellë kartën e saj të kreditit, Apple Card. Do të jetë i disponushëm në celularët iPhone, por edhe si kartë normale që do fillojë funksionimin në verë, thotë kompania. Versioni i iPhone merr 2% interes për çdo blerje, nuk ka tarifa të vonuara, tarifa vjetore ose pagesa ndërkombëtare, tha zëvendës drejtoresha e Apple Pay, Jennifer Bailey. Karta është krijuar me ndihmën e Goldman Sachs dhe MasterCard. Firma mbajti një ceremoni në Kaliforni, SHBA për të njoftuar një numër shërbimesh të reja dhe të zgjeruara. Shefi Ekzekutiv Tim Cook ishte i qartë duke thënë se eventi mbahej për të njoftuar shërbimet e reja, jo pajisjet e reja. Karta Apple është një ndryshim për gjigantin 42-vjeçar të teknologjisë.

Fjalëkalimet e 600 miliona përdoruesve të Facebook ishin publike 7 vite me radhë

Fjalëkalimet e qindra miliona përdoruesve të Facebook dhe Instagram mund të jenë ekspozuar si pasojë e një mbikëqyrje nga kompania e rrjeteve sociale. Kjo gjë u zbulua nga hulumtuesi i sigurisë Brian Krebs, i cili raporton se Facebook publikoi fjalëkalimet e gati 600 milionë përdoruesve. Kjo do të thotë se informacioni ishte i lexueshëm dhe i kërkueshëm nga më shumë se 20,000 punonjës të Facebook që nga viti 2012. Facebook ka konfirmuar tashmë dështimin tronditës të sigurisë, por këmbëngul se ka rregulluar çështjen dhe nuk ka gjetur ndonjë dëshmi se informacioni është publikuar në vende të tjera.

Lirohet i pafajshëm pas 36 vitesh burgim

Një burrë që bëri 36 vjet burg për një përdhunim dhe vrasje të supozuar, rezultoi i pafajshëm. Ai u arrestua për një ngjarje të ndodhur në vitin 1982 dhe u lirua javën e kaluar. "Projekti i pafajësisë", një organizatë jofitimprurëse arriti që të sigurojë prova që e deklaronin Archie Williams të pafajshëm. I dënuari i kishte shkruar organizatës së lartpërmendur një letër për ndihmë në vitin 1995. Atë kohë ai ishte 35 vjeç dhe tashmë ka dalë nga burgu në moshën 58-vjeçare.

Komisioneri i projektit, Kinasiyumki Kimble, muajin e kaluar kishte kërkuar disa të dhëna të zgjeruara nga FBI, përfshi këtu

gjurmët e gishtërinjve, duke përdorur teknologjinë e avancuar. Prokurorët ranë dakord me këtë kërkesë. Në dhomën e gjumit të Baton Rouge u gjetën gjurmë të shumta gishtërinjsh dhe ndonëse nuk përputheshin me ato të William-it, nuk u morën parasysh. "FBI doli në konkluzionin se gjurmët e gishtave të marra nga skena e krimit çuan në identifikimin e një burri tjetër, Stephen Forbes, i cili kishte pranuar përdhunime të shumta pas vitit 1986", tha 'Projekti i Pafajësisë'.

Nëse komisioneri Kimble nuk kishte këmbëngulur, dhe Ndihmësja e Parë e Prokurorit të Qarkut Dana Cummings nuk do të kishte rënë dakord për kërkimin e rishikimit të gjurmëve të gishtave, William do të vdiste në burg.



Rrjeti social më i ri që po konkurron Instagramin

Për ata që humbën Vine Video, tani mund të gjejnë ngushëllim tek Tik Tok. Aplikacioni Kinez i videove të shkurtra është shkarkuar rreth 80 milion herë në Shtetet e Bashkuara, dhe afërsisht 800 milion herë në të gjithë botën. Këto shifra përjashtojnë përdoruesit e Android në Kinë. Përdoruesit shpërndajnë video të shkurtra të tyre duke gatuar, kërcyer, lëvizur buzët, ose duke larë dhëmbët. Videot, të cilat ofrojnë muzikë në sfond, mund të shpejtohen, ngadalësohen, ose të editohen me filtra.

Ashtu si Instagrami, përdoruesit mund të ndjekin të tjerët dhe të pëlqejnë ose komentojnë videot. Videot gjithashtu mund të ripostohen në platforma të tjera, si Twitter dhe Instagram.

PAS ÇDO DHIMBJE DHËMBI FSHIHET NJË PROBLEM SHËNDETËSOR!

Sikurse e shpjegojnë ekspertët, premolarët pasqyrojnë gjendjen e mushkërive, molarët tregojnë shumë për gjendjen e stomakut, shpretkës dhe pankreasit, dhe dhëmballët e pjekurisë lidhen me zemrën edhe zorrën e vogël

Dhimbja e dhëmbit është padyshim një prej dhimbjeve, e cila është e pakëndshme. Secili prej nesh një herë të paktën në jetë, ka provuar ndjenjën e dhimbjes së dhëmbit. Por si shfaqen ato dhe cilat janë simptomat që e shoqërojnë dhe si të veprojmë në atë situatë? Shumë pak e dinë që dhimbja e dhëmbëve, mund të jetë shenjë e një problemi në trupin tonë. Kjo sepse dhëmbët e poshtme dhe të sipërme lidhen me veshkat, fshikëzën dhe veshët ndërsa dhëmbët e qenit janë të lidhur me gjendjen e mëlçisë dhe fshikëzës së tëmthit.

Sikurse e shpjegojnë ekspertët, premolarët pasqyrojnë gjendjen e mushkërive, molarët tregojnë shumë për gjendjen e stomakut, shpretkës dhe pankreasit, dhe dhëmballët e pjekurisë lidhen me zemrën edhe zorrën e vogël. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se të gjitha dhimbjet apo sëmundjet e brendshme shoqërohen nga dëmtimi i dhëmbëve. Por nëse jeni duke përjetuar dhimbje në dhëmbët premulare, shkaku mund të jetë koliti, reaksionet alergjike dhe pneumonia. Nëse jeni duke përjetuar dhimbje tek dhëmbët e qenit, kjo gjë mund të lidhet me hepatitin.

Nëse keni dhimbje tek dhëmbët e katërt (lart dhe poshtë), ndoshta mund të vuani nga dhimbjet e gjunjëve, bërrylave, shpatullave ose sëmundjet e lidhura me inflamacion, si artriti. Sa i përket dhimbjes tek dhëmbët molarë, arsyet mund të jenë ulçera e stomakut, pankreati kronik, anemia, gastriti kronik. Ndërkohë, mënyrat për të parandaluar dhimbjen e dhëmbit në kushte të shtëpisë janë të shumta. Uji i kripur është një dezinfektues natyral dhe gjithashtu një ilaç efektiv për të kuruar dhimbjen e dhëmbit. Në një gotë me ujë të ngrohtë shtoni gjysmë lugë gjelle me kripë dhe me të bëni gargare. Përzierja parandalon ënjtjen dhe pastron zonën e irrituar. Alternativa të tjera janë edhe kompresat e ftohta, hudhrat dhe qepat: mbani një kompresë të tillë për 15 minuta në zonën kur keni kriza dhe dhimbje. Shtypeni hudhrën mirë e mirë derisa të krijoni një pastë. Lyeni zonën problematike për të vrarë mikrobet dhe qetësuar dhimbjet. Qepa ka po ashtu të njëjtin efekt. Prisni një copë të vogël dhe vendoseni aty ku keni dhimbje.



Zbulimi surprizues mbi spermatozoidët

Spermatozoidët me të vjetër në botë janë aktivë. Bëhet fjalë për qelizat riprodhuese mashkullore të një dashi të ngrira 50 vjet më parë, të cilat shkencëtarët i kanë përdorur për të fekonduar 56 dele, nga të cilat kanë lindur tashme 34 qengja.

Përqindja e lartë e suksesit është pothuajse e njëjtë me atë të spermatozoidëve, të cilët i ishin nënshtruar procesit të ruajtjes në ngrirje në azot të lëngshëm prej disa muajsh.

Ekspertët shprehen të surprizuar nga rezultatet e këtij eksperimenti, pasi kjo tregon se këto qeliza janë pjellore edhe pas shumë dekadash, si në rastin konkret, ku ata mbijetuan duke mos humbur asnjë vlerë. Eksperimenti është kryer nga universiteti australian i Sydneyt.

Çaji i zi parandalon plakjen

Nëse pini çaj të zi ju keni përfitime për lëkurën tuaj. Lëkura e juaj ka tre përfitime nga ky çaj; ajo ushqehet me vitaminat B2, C dhe E, gjithashtu edhe me magnez, kalium dhe zink. Sipas The Spruce Eats, më pas kafeina e çajit të gjelbër ju mbron nga infeksionet rreth gojës suaj. Përveç këtyre përfitimeve, ju do të mbroni lëkurën tuaj nga rrudhat e hershme. Çajin e zi mundeni ta vendosni drejtpërdrejtë në lëkurën tuaj, sidomos poshtë syze pasi do të largohet të zitë që e keni.

Si ndikon sporti tek fëmijët

Përfshirja në një skuadër sportive vepron si një antidepresiv për adoleshentët. Janë kërkuesit e universitetit të Washington në St Louis që kanë studiuar rreth 5 mijë fëmijë të moshave nga 9-11 vjeç që ushtroheshin në sport. Dhe nga ekzaminimet cerebrale të tyre rezulton se zona e ipokampit ka një volum më të madh, por edhe reduktim të depresionit e shqetësimeve të tjera të moshës në krahasim me të tjerët. Pra shkenca provon atë që njeriu e ka vërtetuar me eksperiencë. Ata që luajnë në skuadër dhe stërviten në mënyrë të rregullt dhe profesionale shfaqin një ndërveprim më të lartë social, por edhe disiplinë dhe bashkëpunim me të tjerët. Autorët e studimit shpjegojnë se përfshirja në një grup apo skuadër sportive ndikon në modifikimin pozitiv të strukturës së trurit.

Shtatzënat të qëndrojnë larg pesticideve

Ekspozimi ndaj pesticideve para lindjes, apo në vitin e parë të jetës mund të jetë një faktor kyç, që ndikon në shfaqjen e shqetësimeve të spektrit të autizmit. Madje në rastet më të rënda duket se ndikon deri në 50%. Studimi më i madh i kryer deri më sot është publikuar në revistën mjekësore British Medical Journal. Por autorët shpjegojnë se ky studim mund të tregojë vetëm një lidhje të mundshme mes pesticideve dhe autizmit dhe jo një raport shkak-pasojë.

Kërkuesit e universitetit të Californisë kanë studiuar të dhënat e rreth 38 mijë fëmijëve, 2961 prej të cilëve me diagnozën e autizmit. Familjet e tyre jetonin në një zonë bujqësore në SHBA ku përdorimi i pesticideve apo antiparazitarëve ishte relativisht i lartë. Nënat që gjatë shtatzënisë kishin jetuar në një rreze prej 2 km në zonat me përdorim të lartë të pesticideve ishin 15% më tepër të ekspozuara për të pasur fëmijë autikë. Nëse edhe fëmija kishte të njëjtin ekspozim në vitin e parë të jetës, rreziku arrinte në 50%.Të njëjtët studiues këshillojnë që për të evituar impaktin negativ mbi zhvillimin neurologjik duhen evituar zonat e tilla. Statistikat botërore theksojnë se autizmi në vitet e fundit ka pësuar rritje të dukshme në vendet e industrializuara, madje ky numër po shtohet dita ditës edhe në Maqedoni.

BESIMI I LUHATUR NË BE-në

Reagime të liderëve dhe zyrtarëve tjerë të institucioneve të Kosovës që shfaqin mosbesim, por edhe kritika me fjalor të ashpër në adresë të BE-së, ka pasur që nga vitit 2017 e këndej, qoftë për çështjen e liberalizimit të vizave, qoftë për çështje që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi

Drejtuesit institucionalë të Kosovës, por edhe qytetarët e vendit, në përgjithësi kanë pasur besim të plotë ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, por besimi i tillë tashmë është zbehur mjaft, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve në Kosovë. Sipas tyre, në vitet e fundit, raportet ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian janë cenuar për shkak se nuk ka pasur përparim kualitativ të vendit drejt BE-së, pavarësisht se kjo e fundit ka investuar mjaft në Kosovë dhe prania e saj në zhvillimin institucional ka qenë domethënëse. Njohësja e zhvillimeve politike, Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës, duke folur për Radion Evropa e Lirë, shpjegon se një nga arsyet e humbjes së besimit të qytetarëve dhe liderëve institucionalë të Kosovës në Bashkimin Evropian apo mekanizmat e tij, ndërlidhet me çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e vendit.

Siç thotë ajo, Kosova kishte marrë premtime publike nga zyrtarët e lartë të BE-së që me ratifikimin e Marrëveshjes për demarkacion me Malin e Zi nga Kuvendi i Kosovës, liberalizimi i vizave do të jepej për qytetarët e vendit."Duhet të thuhet që ky raport është dëmtuar për shkak të mungesës së liberalizimit të vizave nga ana e Bashkimit Evropian për qytetarët e Kosovës, veçanërisht pas miratimit të Marrëveshjes për demarkacionin e kufirit (me Malin e Zi) në Kuvendin e Kosovës. Në anën tjetër, një faktor tjetër që ka ndikuar në dëmtimin e raporteve apo të perceptimit të qytetarëve në Bashkimin Evropian apo në vetë zonjën (shefen e diplomacisë së BE-së, Federica) Mogherini, është dialogu Kosovë-Serbi dhe veçanërisht deklaratat që janë lëshuar nga zonja Mogherini. Qytetarët në Kosovë, në përgjithësi i kanë parë si deklarata, deri diku, të njëanshme, ku i njëjti qëndrim nuk është reflektuar si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë", theksoi Krasniqi.Mendim të ngjashëm shpreh edhe analisti i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri.

Ai thotë për Radion Evropa e Lirë se mosrespektimi i premtimeve që Bashkimi Evropian ia ka dhënë Kosovës për liberalizimin e vizave, përkundër plotësimit të numrit të madh të kritereve të parashtruara në krahasim me vendet tjera të rajonit, ka dëmtuar besimin e qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës ndaj BE-së.Për më shumë, sipas tij, dobitë për Kosovën, në procesin e dialogut me Serbinë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, kanë qenë shumë të vogla.

"Përkundrazi, Serbia është faktorizuar edhe në aspektin e nacionalizmit si dhe në aspektin e tentimit të zhbërjes së pavarësisë së Kosovës, me investimin e madh në zhbërjen e njohjeve. E gjithë kjo është bërë para syve të BE-së dhe me një miratim të heshtur të saj. Ka pasur edhe raste të tjera, siç është për shembull, rasti i trenit të famshëm religjioz-nacionalist, për të cilin, në fund, çuditërisht, u vlerësuar presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, si një person i cili e ndali atë dhe e parandaloi të keqen", tha Muhaxhiri.Çështje e besimit ndaj Bashkimit Evropian e kanë potencuar edhe liderët institucionalë të Kosovës.Së fundmi, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë për media, ditën e martë, duke iu referuar një deklarate të eurodeputetes dhe raportueses për liberalizimin e vizave për Kosovën në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, se liberalizimi i vizave nuk mund të ndërlidhet me taksën që Kosova ka vënë ndaj mallrave të Serbisë, ka ngritur pikëpyetjen nëse mund t'u besohet zyrtarëve të BE-së."Tani, si t'ju besojmë evropianëve, që një herë na thanë 'dialogun', tash na thonë 'taksën'. Ku ta dimë se çka na thonë më tutje. Është bërë pak zor t'iu besohet atyre se a është e vërtetë kjo që e thotë zonja (Fajon) në fjalë", ka thënë Haradinaj.Megjithatë, njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se deklaratat e drejtuesve të institucioneve të Kosovës duhet të jenë shumë të matura, për shkak se rruga të cilën e ndjek vendi është drejt anëtarësimit në BE dhe në strukturat euroatlantike, si dhe nuk ka ndonjë alternativë tjetër. Krasniqi, vlerëson që kërkesat e Kosovës duhet të jenë të qarta drejt Bashkimit Evropian, por duhet gjetur mënyra që marrëdhënia Kosovë-BE të fuqizohet."Një gjë mbetet, që duhet përmendur, që Bashkimi Evropian ka një status neutral ndaj shtetit të Kosovës dhe kjo në perceptimin e qytetarëve shihet pak me skepticizëm. Është më se e qartë dhe më se e nevojshme që pala e Kosovës t'i artikulojë qartazi kërkesat e saj që ka ndaj BE-së, por të marrë përsipër edhe përmbushjen e obligimeve, të cilat i ka marrë. Dëmtimi i raporteve na dëmton drejtpërdrejtë neve dhe ne duhet të shohim që të jemi më pragmatik në raportet që i ndërtojmë me BE-në, institucionet e saj dhe shtetet anëtare të BE-së", u shprehë Krasniqi.Ndërkaq, Muhaxhiri e sheh BE-në si alternativën e vetme për Kosovën dhe politikanët e vendit, sipas tij, duhet të jenë të matur për të mos i dëmtuar raportet me BE-në."Ata duhet ta ngritin zërin dhe të jenë dinjitoz në kërkesat e bazuara në raport me BE-në. Të gjitha kritikat e spektrit politik duhet të bëhen deri në atë masë, e cila nuk e dëmton raportin e Kosovës me BE-në, gjithsesi, duke i marrë edhe përgjegjësitë për dështimet e mëdha të vet politikanëve të Kosovës, në përmbushjen e kritereve të agjendës evropiane të vendit", vlerësoi Muhaxhiri.Reagime të liderëve dhe zyrtarëve tjerë të institucioneve të Kosovës që shfaqin mosbesim, por edhe kritika me fjalor të ashpër në adresë të BE-së, ka pasur që nga vitit 2017 e këndej, qoftë për çështjen e liberalizimit të vizave, qoftë për çështje që ndërlidhen me dialogun Kosovë-Serbi.

Shqipëria po vuan pasojat e plakjes

Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) vazhdon të bjerë në shumicën Europës Perëndimore, por fenomeni ka përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor.

Raporti Rajonal për Trendet e Punësimit më 2019 i Bankës Botërore vërejti se, nga tremujori i dytë i vitit 2017 deri në tremujorin e dytë të vitit 2018 popullsia në moshë pune në vendet e Ballkanit Perëndimor ka rënë me 0.8 për qind. Por rënien më të madhe e ka pësuar Shqipëria me 1.6%.

Në Serbi popullsia në moshë pune ra me 1.5 për qind, ndërsa në Malin e Zi mbeti e pandryshuar.

Në Kosovë, popullsia në moshë pune u rrit me 0.9 për qind. Rënie u regjistrua edhe në vendet e BE-së, me përjashtim të Austrisë, ku popullsia në moshë pune mbeti e njësoj.

Midis 2012 dhe 2017, Ballkani Perëndimor përjetoi një rritje të punësimit të popullsisë në moshë pune së bashku dhe kjo u shoqërua me rënie të inaktivëve.

Serbia, e ndjekur nga Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, raportoi rritjen më të madhe të punësimit, ndërsa pjesa e joaktive ra në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi.

Rënia më e madhe e papunësisë u raportua për Serbinë, Maqedoninë e Veriut, Bosnjen, ndërsa ulja ishte modeste në Mal të Zi.

Pjesa e të papunëve është rritur në Shqipëri dhe Kosovë, por ritmet më të ulëta të pasivitetit tregojnë një lëvizje në drejtimin e duhur.

Për krahasim, në vendet partnere, pjesa e të punësuarve në popullsinë në moshë pune u rrit më së shumti në Hungari, pasuar nga Bullgaria dhe Kroacia. Pjesa e personave joaktivë në tregun e punës ra në të gjitha vendet partnere.

Kosova është i vetmi vend ku rritet norma e papunësisë tek meshkujt, ndërsa shkalla e papunësisë tek femrat është ulur paksa. Në Shqipëri rritja e shkallës së papunësisë ndër femra ishte dy herë më e lartë se së e meshkujve.

Kosova synon të mbyll lojërat e fatit pas vdekjes së dy personave në kazino

Agjensia Ndërkombëtare e lajmeve Reuters ka shkruar për vendimin e Qeverisë së Kosovës për mbylljen e lojërave të fatit për 10 vjet. Sipas Reuters ky vendim i Qeverisë ka ardhur pas dy grabitjeve të armatosura që ndodhën së fundi në kazino ku mbetën të vdekur dy persona."Pas vdekjeve, zyrtarët e doganave bastisën me dhjetëra dyqane të lojërave të fatit dhe gjetën se shumë prej tyre vepronin në mënyrë të paligjshme. Më shumë se njëqind makina të lojërave u konfiskuan"."Vetëm një lotari e kontrolluar nga shteti do të jetë në gjendje të veprojë, tha Kryeministri Ramush Haradinaj gjatë një seance të martën, në të cilin Kabineti i Qeverisë votoi për të mbështetur ndalimin 10 vjeçar"."Është kaos total, një abuzim total dhe është mirë që ne po e ndalim këtë," tha Haradinaj në një konferencë shtypi. Propozimi i ndalimit tani do të dërgohet në parlament për miratim". "Industria e lojërave të fatit është rritur me shpejtësi në dhjetë vitet e fundit. Shoqata e Lojërave të Fatit të Kosovës thotë se 4000 persona janë të punësuar në këto biznese. Ruzhdi Kosumi, i cili zotëron 14 dyqane të lojërave të fatit, tha se 40 punëtorë të tij do të mbeten të papunë", shkruan Reuters.

TENSIONET NË GAZA MUND TË ÇOJNË NË PASOJA KATASTROFIKE

"Ngjarjet në dy ditët e fundit treguan se sa jemi afër pragut të luftës", tha Mladenov, koordinatori për procesin e paqes në Lindjen e Mesme

Koordinatori Special i Procesit të Paqes në Lindjen e Mesme i Kombeve të Bashkuara (OKB), Nickolay Mladenov, shprehu shqetësime se tensionet në Gaza mund të çojnë në pasoja katastrofike. Duke folur në Keshillin e Sigurimit të OKB-së, Mladenov tha se përplasja e re në Gaza nuk do të jetë në interes të asnjërës palë dhe paralajmëroi Palestinën dhe Izraelin se konflikti do të krijojë "pasoja shkatërruese" në rajon.

"Mund të përballemi me një tension të rrezikshëm që mund të rezultojë edhe një herë me një katastrofë në Gaza. Ngjarjet në dy ditët e fundit treguan se sa jemi afër pragut të luftës", tha Mladenov, duke bërë thirrje për ruajtjen e qetësisë. Mladenov theksoi nevojën për ndalimin e raketave të shkrepura nga Gaza në drejtim të Izraelit, ndërsa po ashtu u bëri thirrje forcave izraelite të përmbahen. Ndryshe, qeveria izraelite mbylli dy porta kufitare të Gazës pasi shtatë persona u plagosën dje në mëngjes si pasojë e një rakete që ra në veri të Tel Avivit.

Presidenti amerikan Donald Trump dje firmosi një dekret që "zyrtarisht njeh sovranitetin izraelit mbi Lartësirat e Golanit", përkundër rezolutës 497 të OKB-së të miratuar në vitin 1981, e cila e cilëson si të paligjshëm pushtimin izraelit të këtij rajoni. Izraeli prej vitit 1967 mban nën pushtim Lartësirat e Golanit, të cilat janë rajon i Sirisë. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se ndihet "i pikëlluar" nga reagimet që kanë ardhur nga shumë vende, kryesisht nga Turqia, pasi presidenti Donald Trump njohu kontrollin e Izraelit mbi Lartësirat e Golanit. "Jam i pikëlluar, por jo i befasuar", tha Pompeo duke folur në një konferencë për shtyp në Departamentin e Shtetit, i pyetur se "si e prisni reagimin e Turqisë, Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Kanadasë në lidhje me Lartësirat e Golanit".

"E mbaj mend edhe kohën kur morëm vendimin për të zhvendosur ambasadën tonë në Kuds. Ne marrim për bazë faktet në terren për secilën çështje dhe shpresojmë që edhe vendet e tjera do të kuptojnë rëndësinë e kësaj situate duke u bashkuar me ne. Bisedimet tona me këtë pjesë të vogël të vendeve do të vazhdojë", tha Pompeo. Ndërkaq, në pyetjen se "A mund të marrin çdo territor që dëshirojnë vendet e fuqishme pavarësisht ligjit ndërkombëtar", Pompeo tha: "Kategorikisht që jo, por kjo është një situatë shumë e veçantë. Izraeli po bën mbrojtje".

SIRIA THIRRJE PËR MBLEDHJE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR GOLANIN

Siria i ka bërë thirrje Këshillit të Sigurimit të OKB-së të mbajë një mbledhje urgjente mbi Lartësitë e Golanit, bëjnë të ditur disa burimeve diplomatike. Thirrja e Sirisë erdhi pas vendimit të diskutueshëm të presidentit të SHBA-ve, Donald Trump, për të njohur sovranitetin izraelit mbi Lartësitë e pushtuara të Golanit. Të hënën, Trump nënshkroi dekretin presidencial që zyrtarisht njohu Golanin si territor izraelit. Sipas OKB-së, statusi ligjor i Golanit do të mbetet i pandryshuar, pavarësisht njoftimit të Trumpit, dhe ende konsiderohet "territor i pushtuar" sipas ligjit ndërkombëtar.

RREGULLA TË REJA PËR TË DREJTAT AUTORIALE NË INTERNET

Rregullat e reja që përfshijnë "masa mbrojtëse për lirinë e shprehjes", u miratuan me mbështetjen e 348 votave, ndërsa 274 eurodeputetë ishin kundër dhe 36 të tjerë abstenuan nga votimi

Parlamenti Evropian (PE) njoftoi të martën për miratimin e rregullave të reja për të drejtat autoriale në internet. Creatives dhe publikuesit e lajmeve do të marrin kompetenca shtesë për të negociuar me gjigantët e internetit në përputhje me rregullat e reja të të drejtave të autorit, thuhet në njoftimin e PE-së. Rregullat e reja që përfshijnë "masa mbrojtëse për lirinë e shprehjes", u miratuan me mbështetjen e 348 votave, ndërsa 274 eurodeputetë ishin kundër dhe 36 të tjerë abstenuan nga votimi.

Rregullativa e re ligjore do t'u mundësojë krijuesve të përmbajtjeve, muzikantëve, interpretuesve, autorëve të skriptave online si dhe botuesve të lajmeve, të negociojnë marrëveshje me të favorshme me gjigantët e teknologjisë, siç janë YouTube, Facebook dhe Google News. "Aktualisht, kompanitë e internetit kanë joshje për të nënshkruar marrëveshje licencimi me pronarët e të drejtave autoriale nga shkaku se nuk i nuk konsiderohen ata përgjegjës për përmbajtjen të cilën e ngarkojnë përdoruesit e tyre", tha Parlamenti. Theksohet se rregullativa e re ligjore do të bëjë kompanitë e internetit të jenë të detyruara që bartësve të të drejtave autoriale t'u sigurojnë marrëveshje korrekte licencimi.

Parlamenti Evropian thotë se platformat jokomerciale, siç është Wikipedia nuk do preken nga ky ligj. Eurodeputeti Axel Voss, nga ana e tij tha se "kjo direktivë është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të çështjes e cila kishte lejuar që disa kompani të fitojnë shuma të mëdha parash pa paguar siç duhet mijëra krijues dhe gazetarë nga puna e të cilëve ata varen". Ai shtoi se kjo njëherësh mbron demokracinë, shton lirinë e shprehjes dhe inkurajon fillimin dhe zhvillimin teknologjik.

Një front europian përballë Kinës

Presidenti francez, Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane, Angela Merkel ritheksuan dje para homologut të tyre Xi Jinping një partneritet më të ekuilibruar mes Kinës dhe Europës. Gjatë një mini-samiti të pazakontë në Elize, krerët e dy fuqive kryesore europiane, të shoqëruar nga presidenti i Komisionit Europian, Jean Claude Juncker, u përpoqën të mishërojnë një front të bashkaur europian përballë ambicieve ekonomike dhe strategjike të Kinës. Presidenti francez, Emmanuel Macron, që kishte ndërmarrë iniciativën e këtij takimi, nxiti Kinën që të "respektojë Bashkimin Europian", ndërkohë që Pekini dyshohet se po përpiqet të përçaje vendet europiane nëpërmjet politikës së tij të investimeve.

Myslimanët francezë padisin Facebookun e Youtuben

Një grup që përfaqëson myslimanët francezë ka paditur Facebookun dhe YouTuben, për lejimin e transmetimit të pamjeve nga sulmet në Christchurch në platformat e tyre, ani pse këto kompani kanë thënë se e kanë pasur të pamundur të ndërprenë transmetimet. Sulmet e 15 marsit në dy xhami në Zelandën e Re, ku mbetën të vrarë 50 persona, u transmetuan drejtpërdrejt në Facebook dhe video u kopjua dhe u shpërnda edhe në të gjitha rrjetet e tjera sociale. Në padinë e Këshillit Francez të Besimit Mysliman thuhet se Facebook edhe Youtube lejuan transmetimin e pamjeve të dhunshme duke i dhënë mbështetje terrorizmit ose akteve që tentojnë të shkelin dinjitetin njerëzor. Padia është mirëpritur nga Shoqata Islame e Zelandës së Re. Ata thanë se autori i sulmit kërkonte një audiencë dhe Facebook ia mundësoi që ai të reklamonte veten dhe krimin e tij.

15 FAKTE, QË NDOSHTA NUK I DINIT PËR JETËN E FROJDIT



Pionier i terapisë së kafshëve, i tmerruar nga numri 62, i kënaqur me veset e tyre. Ja cilat janë aspektet e habitshme të jetës së Sigmund Frojdit, "babait" të psikoanalizës dhe interpretimit të ëndrrave



KUSH ISHTE SIGMUND FROJDI. Lindi më 6 maj 1856 në Frajberg (Pribor), në Republikën e sotme Çeke. Doktor dhe themelues i psikoanalizës, ai e identifikoi tek e pandërgjegjshmja vendin e instikteve dhe të dëshirave, dhe tek konfliktet e pazgjidhura, shkakun e histerive dhe neurozave. Duke përmbysur një traditë mijëvjeçare, që e shihte psikikën si diçka të padepërtueshme ndaj arsyes, ai e bëri atë pikënisjen prej nga ku do të analizonte pacientin. Edhe sot Frojdi është objekt i studimeve, por sa ishte gjallë puna e tij nuk u vlerësua sa duhet, dhe teoritë e tij shiheshin me dyshim.

PIONER I TERAPISË SË KAFSHËVE. Frojdi mbante gjithmonë në studion e tij, Jofin, qenin e tij të racës Choë Choë. Frojdi e konsideronte jetike praninë e tij gjatë seancave të psikoanalizës, pasi ishte qetësuese për pacientët. Jofi u mësua të ndjekë seancat e të zotit, sa që me nisi të llogarisë kohën e çdo takimi. Kur qeni ngrihej në këmbë, Frojdi e dinte se seanca kishte mbaruar.

FRIKËRAT E NJERIUT QË ZBULONTE FOBITË. Thuhet se Frojdi ishte i fiksuar pas numrit 62. Ai besonte se pikërisht në atë moshë, 62 vjeç, ai do të vdiste (në fakt jetoi deri në moshën 83-vjeçare). Për këtë arsye, ai nuk fjeti kurrë në një dhomë hoteli që kishte atë numër.

NJË RUTINË GJENIALE. Zakonet e Frojdit, ishin shumë strikte. Paraditen ua kushtonte pacientëve, hante çdo ditë drekën në orën 13:00. Donte mish viçi, dhe urrente mishin e pulës. Pas drekës, dilte për një shëtitje prej 3 kilometrash, duke ndjekur gjithmonë të njëjtat rrugë. Pasdite merrej sërish me vizitat, dhe pas darke luante letra me gruan ose vajzën e tij.

DIVANI ISHTE NJË DHURATË. Divan i famshëm, ku ai psikoanalizonte pacientët, ishte dhuratë nga një paciente, zonja Benevenists. Ideja që pacientët të qëndronin të shtrirë në divan, i erdhi në kohën kur ai praktikoi hipnozën, dhe zbuloi se njerëzit binin më shpejt në një gjendje transi, nëse ishin shtrirë.

KONSUMATOR FRENETIK I DUHANIT. Frojdi i adhuronte purot. Ai tymoste 20 në ditë. Për shkak të purove dhe cigareve që pinte kur ishte i ri, Frojdi u prek nga një tumor i rëndë në fyts, që çoi edhe në vdekjen e tij në vitin 1939. Kur dhimbjet e kancerit u bënë të padurueshme, ai kërkoi që t'i ndihmohej të vdiste. Mjeku i injektoi një dozë të madhe me morfinë.

PAK RROBA. Në gardërobën e tij, ai kishte vetëm 3 kostume, 3 palë të brendshme dhe 3 palë këpucë. Ndoshta sepse kursente para? Jo, thjesht i dukej e padobishme të blinte rroba të tjera.

MIGRENA DHE KOKAINA. Frojdi vuante shpesh nga dhimbje tmerrshme të kokës. Nga leximi i kujtimeve të tij, u arrit në përfundimin se ai vuante nga migrena, të cilën psikoanalisti u përpoq të shëronte duke përdorur kokainë. E kishte zbuluar këtë drogë që në moshën 28 vjeçare. Nisi ta përdorte si një ilaç kundër ankthit, por u bë i varur prej tij, të paktën deri në moshën 40 vjeçare.

ARRATIA. Kur Gjermania aneksoi Austrinë gjatë Luftës së Dytë Botërore, nazistët pasi dogjën në shesh librat e tij, i hynë në banesë, duke arrestuar vajzën e Frojdit Anën. 'Babai" i psikoanalizës ishte hebre, por mbi të gjitha simpatizantët e Fyhrerit nuk e pëlqyen hetimin e tij mbi të pavetëdijshmen, dhe instinktet e qenies njerëzore.

Falë ndërhyrjes së njërës prej pacienteve të tij, Princeshës Mari Bonapart, Frojdi me gruan dhe vajzën ia dolën të emigrojnë në Paris dhe më pas në Londër. Por 4 motrat e tij, Roza, Maria, Adolfina dhe Paulina, u zhdukën në një kamp përqendrimi. Frojdi arriti të korruptonte disa nazistë, që mbrojtën arkivin dhe një pjesë të trashëgimisë së tij.

POLIGLOT AUTODIDAKT. Përveç gjermanishtes, Frojdi zotëronte mirë edhe gjuhën angleze. Kur ishte adoleshent, ai mësoi spanjishten me një shok të klasës, për të lexuar në origjinal "Don Kishotin". Frojdi ishte një admirues i madh i Servantesit.

DEDIKIM NDAJ DUÇES. Shkrimtari Xhakinto Romano, që kishte shkruar një dramë me Napoleonin dhe Musolinin si personazhe, i dhuroi Frojdit një kopje me një dedikim të tillë: "Për Sigmund Frojdin, që do ta bëjë botën më të mirë, me admirim dhe mirënjohje Benito Mussolini dhe G. Forzano".

Nuk dihet nëse Musolini kishte dijeni, por disa besonin se Frojdi ishte dashamirës ndaj udhëheqësit italian. Frojdi reagoi me një shkrim ku i drejtohej Duçes me pyetjen "Ëarum Krieg"? (Pse luftë?), të bashkëshkruar me Albert Ajnshtajn. Dhe një dedikim:"Për Benito Mussolini, me përshëndetjet e një plaku që tek mbajtësi i pushtetit, njeh heroin e civilizimit". Historianët e shpjegojnë këtë respekt me faktin se Frojdi besonte se Duçe mund të parandalonte Anshlusin, domethënë aneksimin e Austrisë në Rajhun Gjerman.

FROJDI "SHKOI" NË HËNË. Në satelitin natyror të Tokës, ekziston një krater i vogël që mban emrin e psikoanalistit gjerman. Ajo ndodhet disa kilometra në perëndim të Vallis Schröteri, një luginë e gjerë dhe e thepisur hënore, që ka një diametër prej vetëm 2 kilometrash.

PATI 12 NOMINIME PËR ÇMIMIN NOBEL. Por në fakt nuk fitoi asnjërin. Dhe nominimet u ndërprenë kur një ekspert, i emëruar nga komiteti i Nobelit, pohoi se puna e Frojdit nuk kishte baza shkencore.

GRUMBULLOI GATI 2000 OBJEKTE ARKEOLOGJIKE. Sot kjo do të qe diçka e paligjshme, por në kohën e Frojdit cilësohej e pranueshme. Shumë prej relikeve vinin nga gërmimet në mbarë botën. Ato ndodhen edhe sot në shtëpinë e vjetër të familjes, që sot është një muze i hapur për publikun.

ÇFARË NA MBETET NGA FROJDI? Shumë aspekte të analizës së tij, janë hedhur poshtë nga psikologjia moderne. Por, tek Frojdi vlerësojmë intuitën gjeniale, si fakti që ndjenjat, idetë, impulset, dëshirat, ngjarjet dhe veprimet kanë kuptime të rëndësishme dhe shpesh të pavetëdijshme (pa ndjenja); se eksitimi seksual nuk kufizohet vetëm në organet gjenitale; se e shkuara ka gjithmonë një ndikim në të tashmen, dhe se të folurit ndihmon në lehtësimin e ankthit, dhe çliron mendjen e një personi.

STUDIOI EDHE GAZRAT. Frojdi studioi skutat më të errëta të shpirtit të njeriut, deri edhe tek gazrat që ai lëshon. Në parathënien e edicionit të dytë të librit "Eskursioni dhe Qytetërimi", Xhon Burke zbuloi motivet e pavetëdijshme të neverisë që kanë njerëzit ndaj fryrjes së barkut dhe gazrave. "Njerëzit e civilizuar ndihen në siklet, nga gjithçka i kujton atyre origjinën e tyre shtazore. Ata përpiqen dëshpërimisht të imitojnë engjëjt e përsosur, por tek ta mbetet ende një gjurmë tokësore, që mezi durohet".



Pasi rruajti kokën, Conchita kthehet në mashkull dhe "çmend" vajzat

Rreth 170 milion njerëz në të gjithë botën panë triumfin e këngëtares austriake Conchita, kur ajo (që më parë kishte qenë ai) fitoi 290 pikë me performancën në Eurovizion, duke rrëmbyer kupën e fituesit në vitin 2014, teksa përfaqësonte Austrinë. Jo vetëm kaq, por Conchita u përfol gjatë dhe për look-un e saj me flokët e gjata dhe me mjekër. Pas Eurovizionit, këngëtarja u



paraqit edhe me kokën e rruar, duke vendosur të heqë dorë nga personazhi i vjetër dhe të vazhdojë karrierën me emrin e tij të vërtetë dhe mashkullor, Tom. Mirëpo së fundmi, Conchita duket se e ka fshirë totalisht të kaluarën, pasi në videoklipin e ri duket të jetë kthyer sërish në mashkull, këtë herë prej vërteti. Conchita shfaqet me mjekër të bardhë dhe flokët e prera shkurt, ndërsa duket shumë simpatik dhe vajzat po çmenden pas tij duke e komplimentuar në rrjete sociale për look-un e ri.



"JACKSON FLINTE ME TË TJERËT DERISA UNË QAJA NË DHOMËN NGJITUR"

"E kuptova se më nuk isha i veçantë. Ishte një natë që e mbaj mend shumë mirë, Michael ishte duke fjetur me një djalosh tjetër në dhomë, ndërsa unë në divan. Kam qarë gjithë natën", përshkruan James në film

Pluhuri i ngritur rreth dokumentarit "Leaving Neverland" nuk po qetësohet dot. Filmi përshkruan se si Michael Jackson i kishte joshur djelmoshat dhe i kishte bindur prindërit e tyre se nuk po bën asgjë të gabuar, por vetëm po shoqërohet me djelmoshat. James Safechuck (41) ndërkohë që ishte djalë ishte aq i joshur nga mbreti i popit sa që madje kishte qarë kur Jacksoni flinte me djem të tjerë.

"Ai më përgatiti me faktin se do ta shihja me djelmosha e tjerë. Ai më thoshte se kjo nuk nënkuptonte që ai më donte më pak. Pastaj u shfaq një djalë me të cilin ai u afrua. E pashë që ai djalë do të më zëvendësonte. Kishte shumë xhelozi, unë isha shumë i lënduar. E kuptova se më nuk isha i veçantë. Ishte një natë që e mbaj mend shumë mirë, Michael ishte duke fjetur me një djalosh tjetër në dhomë, ndërsa unë në divan. Kam qarë gjithë natën", përshkruan James në film.

Situatë më e ndryshme nuk ishte as me Wade Robson (36). Interesimi i Jacksonit për djemtë u dobësua me kalimin e kohës, ndërsa gjatë viteve të fundit të abuzimit ata janë ndjerë shumë të lumtur pasi që ishin intim me këngëtarin. Jackson e ndërpriste marrëdhënien intime me djemtë kur ata i mbushnin 14 vjeç, ndërsa deri atëherë ata ishin të varur nga ai emocionalisht. Takimet e tyre kryesisht lidhen me seksin oral, puthjet, dhe stimulimin e thithave të cilin Jackson e adhuronte.

"Herën e fundit që kemi fjetur së bashku ishte kur Michael u përpoq të bënte seks anal me mua, por ishte shumë e dhimbshme. Ishim në hotel. Në mëngjes më vonë ai shkoi në një xhirim dhe më kërkoi të shkoja atje urgjentisht. Më pyeti se çfarë kisha bërë me të brendshmet e mia dhe më dërgoi në shtëpi për t'i shkatërruar brekët, sepse ishte e mundur që në to të kishte gjak. Dhe unë e dëgjova. Mendoj se kjo ishte hera e fundit që kemi fjetur së bashku", përfundoi Wade. James dhe Wade e kuptuan se nëpër çfarë kishin kaluar vetëm kur u bënë prindër. "Vetëm kur lindi ai, e kuptova se çfarë është fëmija, si mendon dhe si sillet. Sekretin për Jacksonin do ta merrja me vete në varr sikur të mos më kishte lindur djali im", thotë Wade në dokumentar.

Dy aktorë pornografikë në librin e meshës!

Një burrë dhe një grua nga prapa, dukshëm të zemëruar: është imazhi që shfaqet në seksionin kushtuar familjes në broshurën masive, me shumë lutje të së dielës.

Është për të ardhur keq që protagonistët e fotos janë Johnny Sins dhe Jayden James, pornostarë amerikanë të njohur dhe është për të ardhur keq që, kur pastori e vuri re, mijëra letra ishin shpërndarë tashmë në mesin e besimtarëve të famullive të San Martín dhe San Vicente në O Grove (Pontevedra), një fshat i vogël në Galicia të Spanjës.

"Fajtorët" janë Don Antonio Varela, 77 vjeç, dhe Juan Ventura Martínez, 34 vjeç, priftërinj të kishave të San Martino dhe San Vicente që me sa duket nuk duhet të kenë parë kurrë ndonjë skenë filmi me "pullë të kuqe" të çiftit në fjalë. Në realitet, autori i fotografisë në fjalë do të ishte Don Antonio Varela, i cili i shpjegoi për |El Mundo", se ai shkon online vazhdimisht për të ilustruar artikujt në fletën e famullisë, të cilën e ka redaktuar për 28 vjet, tani në bashkëpunim me "kolegun" e San Vicentes. Në internet ai gjeti këtë imazh, i cili, tha se "ilustron shumë mirë" objektin e tekstit të tij: "Si mund ta dija nëse është diçka pornografike apo jo?", – pyet veten ai. Vështirë të mos besohet...

Siri Lanka i thotë "stop" thatësirës, krijon shiun artificial

Siri Lanka ka kryer me sukses një test për krijimin e shiut artificiale në një rajon malor ku kultivohet çaji. Vendi e ndërmori këtë masë pasi kjo zonë goditet shpesh nga thatësira.

Por si u realizua ky test? "Një aeroplan i Forcave Ajrore spërkati kimikate në re rreth 8000 metra lartësi , duke nxitur shiun artificial, i cili mbushi rezervuarët në tokë në mënyrë që sigurojnë ujë për të gjeneruar energji hidroelektrike", tha Ushantha Warnakumara, një zëdhënës në Ministrinë e Energjisë. Ministria vendosi të krijonte shira artificiale sepse sezoni i thatë ka ulur nivelet e ujit në rezervuarët që përdoren për të gjeneruar energji hidroelektrike.



Tailanda ka dërguar një ekip të veçantë për të nisur projektin, pasi më parë ka siguruar njohuritë teknike, për të krijuar shira artificiale. "Shirat artificiale të së premtes ishin një projekt pilot dhe ishte shumë i suksesshëm", tha Warnakumara. Ai shtoi se ministria do të vazhdojë të krijojë shirat artificiale gjatë dy javëve të ardhshme në malin e ishullit, ku gjenerohet shumica e energjisë hidroelektrike të vendit. Siri Lanka kryesisht energjinë elektrike e prodhon nga shirat. Gjatë stinëve të thata, vendi përballet me ndërprerje të shpeshta të energjisë. Shumica e hidrocentraleve më të mëdhenj janë ndërtuar në mal, ku rriten lloje të çajit me famë botërore.

ISMAIL KADARE PËRFSHIHET NË BIBLIOTEKËN MË TË BUKUR NË BOTË

Shkrimtari shqiptar lexohet në rreth 50 gjuhë të botës. Tashmë vepra e tij në ndërtesën-ikonë të kulturës në Buenos Aires, e vlerësuar nga National Geographic

I përkthyer në rreth 50 gjuhë të huaja, librat e akademikut dhe shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare tashmë mund të gjenden edhe tek "El Ateneo Grand Splendid", një nga libraritë më të bukura në botë. Kjo librari, e cila ndodhet në Buenos Aires të Argjentinës, është vlerësuar si e tillë nga National Geographic. E vlerësuar si një ikonë e vërtetë e kulturës, kjo ndërtesë është ngritur në vitin 1919.

Fillimisht aty u krijuar teatri Grand Splendid, dhe pas 10 vjetësh u konvertua në kinema, dhe me pas u transformua në një hapësirë ku kultivohej aktiviteti intelektual. E gjithë hapësira bie në sy për një bibliotekë të madhe, që zë pjesën kryesore të librarisë dhe në pjesën e poshtme të sallës gjendet një kafene, në të cilën pushojnë lexuesit e pasionuar të librit. Ndërtesa me kalimin e kohës derisa është kthyer në këtë ikonë botërore të kulturës ka ardhur duke u shndërruar në një stil të ri të me hapësira për muzikën, baletin e të tjera aktivitete.

Ismail Kadare është një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe dhe ndër shkrimtarët më të mirë të letërsisë botërore bashkëkohore, si dhe autori më i përkthyer jashtë vendit. Ai është fitues i disa çmimeve letrare ndërkombëtare dhe i nominuar me dhjetëra herë për çmimin Nobel, ku është vlerësuar me çmime të shumta. Përmendim këtu anëtarësimin në Akademinë e Shkencave Morale dhe Politike në Francë, çmimet prestigjioze si "Prince of Asturias Awards" apo "Man Booker International", e deri tek nderimi që iu bë prej presidentit francez me titullin "Komandant i Legjionit të Nderit."

Me veprën e tij, Kadare e ka bërë të njohur Shqipërinë në botë, me historinë dhe me kulturën e saj shekullore.

Letërsia e Ismail Kadaresë pas vitit 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj që ka krijuar edhe gjatë perudhës së izolimit diktatorial të Shqipërisë: frymën etnografike dhe shpërfaqjen e identitetit shqiptar.

Aktualisht Ismail Kadare është një emër i njohur në botë. Ai është laureat i shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Që nga viti 1994 ai është anëtar i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës dhe anëtar i jashtëm i ASHAK.

Në vitin 2005 fitoi çmimin "The Booker Prize Man". Ismail Kadare më 23.06.2012 u nderua me Çmimin e madh spanjoll, "Princi i Asturias per Letersi", njË nga çmimet më prestigjioze letrare në botë. Ai doli fitues mes 31 kandidateve nga 25 vende të ndryshme të botës ku dallohet emri i Milan Kunderas apo italiani Antonio Cabuçhi. Ismail Kadare është dekoruar gjithashtu nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Urdhrin "Nderi i Kombit" dhe nga shteti francez me urdhrat "Kryqi i Legjionit të Nderit" e "Oficer i Legjionit të Nderit".

Ramë Lahaj për herë të parë me koncert në Shkup

Tenori shqiptar me famë botërore, Ramë Lahaj për herë të parë do të performojë në Operën dhe Baletin e Maqedonisë së Veriut.

Përmes llogarisë së tij në rrjetin social "Facebook", vetë tenori Lahaj ka bërë të ditur se për herë të parë do të performojë në Shkup.

"Për herë të parë do të jem në Shkup, Maqedoni, me miqtë e mi më të mirë të skenës ndërkombëtare në kuadër të festivalit 'Skena e Muzikës serioze shqiptare'. Koncerti do të mbahet në Operën e Shkupit me 4 prill në orën 19:30, ndërkaq Masterclass për artistët e rinj do të mbahet po ashtu në Operën e Shkupit me 5 prill në orën 14:30", ka shkruar ai.

Koncerti "Ramë Lahaj & friends", organizohet nga Festivali "Skena e Muzikës serioze shqiptare" dhe do të dirigjohet nga dirigjenti David Crescenzi dhe krahas tenorit kosovar, do të marrë pjesë edhe sopranoja, Venera Gimodieva, baritoni Kiril Manolov dhe mezo-sopranoja, Marika Popoviq.

Michelle Obama shet 10 milionë kopje të librit

Libri i Michelle Obamas është në "rrugë të mbarë" për tu bërë autobiografia më popullore deri më sot, sipas botuesit të tij.

"Becoming", botuar 5 muaj më parë, tashmë ka shitur më shumë se 10 milionë kopje, ka thënë Bertelsmann. "Ne besojmë se ky libër do bëhet autobiografia më e suksesshme ndonjëherë,, ka thënë Thomas Rabe, shefi ekzekutiv i firmës gjermane. Firma pagoi 60 milionë dollarë në 2017 për të drejtat e librit, së bashku me atë të ish presidentit amerikan Barak Obama. Libri i ish presidentit nuk është botuar ende. Sipas raporteve aktualisht libri i ish Zonës së Parë është aktualisht i 11-ti në listën e 20 biografive dhe autobiografive më të mira.

URAN BUTKA ZBARDH MASAKRËN E TIVARIT NË NJË LIBËR

Historiani Uran Butka promovoi librin "Masakra e Tivarit edhe përgjegjësia e shtetit shqiptar". Në këtë botim, studiuesi sjell dokumente nga arkivat jugosllave, britanike edhe amerikane, të cilat evidentojnë përfshirjen e shtetit komunist shqiptar në këtë masakër

Një ndër plagët më të mëdha, të përgjakshme, por edhe më të pabesa, që është kryer ndaj shqiptarëve të Kosovës është Masakra e Tivarit. Për këtë studiuesi Uran Butka në këtë përvjetor promovon librin "Masakra e Tivarit edhe përgjegjësia e shtetit shqiptar".

Për këtë masakër të projektuar dhe të realizuar nga pushteti komunist jugosllav në muajt mars dhe prill 1945, studiuesi Uran Butka sjell dokumente edhe nga arkivat e huaja. "Në përvjetorin e Masakrës së Tivarit me përmasa ballkanike përurojmë librin "Masakra e Tivarit dhe përgjegjësia e shtetit shqiptar" një botim i ri, sepse pas përvojave të deritanishme të mia gjatë këtyre 25 vjetëve, sot u jepet lexuesve e vërteta e plotë e bazuar mbi dokumente të reja, mbi arkivin e Shqipërisë, mbi arkivat jugosllave, marrja e dokumenteve nga arkivat britanike, amerikane edhe të Kosovës" tha Uran Butka. Nuk mungojnë as 30 intervista me të mbijetuar të masakrës dhe listat e njerëzve të vrarë, për të cilët nuk flitet akoma nga shtetet përkatëse.

"Një nga arsyet e këtij botimi është që të zbulohet e vërteta, nga të gjitha shtetet, që për arsye politike e kanë fshehur. Duke zbuluar të vërtetën ne vlerësojmë edhe historikisht këtë ngjarje edhe dënohen edhe masakrat, që mos të përsëriten më kurrë. Masakra e Tivarit u projektua nga shteti komunist jugosllav, por edhe nga ministria e brendshme, komuniste shqiptare. Kolonat me 13 mijë shqiptarë të kalonin nëpër Shqipëri edhe të vriteshin nga shqiptarët edhe regjimi komunist në tokën shqiptare. Kam treguar me fakte, me dokumentet pjesëmarrjen e brigadave të Ushtrisë Nacional Çlirimtare Shqiptare, që shkuan atje, duke u thirrur nga Titoja, që u vunë për të shtypur revoltat e shqiptare, por edhe për të bërë edhe projektin edhe qëllimin e çubriçnoviçcit, që t'i zhdukim shqiptarët nga Kosova, që u përsërit edhe në vitin 1999. Ndërhyri NATO-ja ndryshe do të kishte ndodhur në Tivar" tha ai.

"Po ashtu edhe në Tivar, ku u vranë 1560 shqiptarë. Ndërsa, në të gjithë rrugëtimin nëpër Shqipëri u vranë 1000 shqiptarë. Këtu është përgjegjësia e shtetit shqiptar. Për shembull, sapo u futën në Kukës nga Prizreni, ata menduan se u çliruan dhe ishin në tokën mëmë, por nja dhjetë kosovarë, që u larguan nga kolonat, u vranë nga rojet shqiptare, nga vet shteti komunist shqiptar, që bashkëpunonte me Jugosllavinë, sepse ishte nën hyqin e Jugosllavisë, për ta bërë edhe Kosovën edhe Shqipërinë, Republikën e shtatë të Jugosllavisë" deklaroi Uran Butka. Por çfarë duhet bërë për zbardhjen e kësaj ngjarjeje? "Në radhë të parë e kanë fjalën historianët, po ashtu edhe shtetet përgjegjës duhet ta njohin këtë masakër, sepse duke e fshehur, plaga majiset, edhe qelbet më shumë brenda trupit dhe jetës së një familjeje, duke e njohur edhe duke kërkuar edhe falje, kapërcehet edhe urrejtja, që është brenda vendeve tona. Unë mendoj edhe që shtetet përkatëse, Serbia, Mali i Zi, edhe shteti komunist shqiptar të kërkojnë falje për këtë masakër, që të kalojnë në paqeje vetëm midis popujve të Ballkanit, por edhe të Europës" përfundoi Uran Butka. Libri u promovua në sallën "Unesco" të Muzeut Historik Kombëtar.

(shqiptarja.com)

LIGA E PARË - JAVA E 24

SHKUPI KËRKON PIKËT NDAJ MAKEDONIJA GJ.P

Kemi pushuar mjaft pasi nuk ka pasur ndeshje kampionale, mirëpo kjo na ka ndihmuar për tu stërvitur dhe kemi punuar shumë mirë me gjithë futbollistët dhe besoj se jemi gati për ndeshjen e radhës dhe për ato tri të tjera, pasi për 10 ditë kemi 4 ndeshje. Jemi gati për të dhënë më të mirën në fushë", deklaroi Bilali

Koha — Fisnik NUHIU

Shkup, 27 mars - Pas pauzës dy javore, shkaku i angazhimit të reprezentacionit të Maqedonisë në ndeshjet kualifikuese për kampionatin Evropian 2020, të enjten në program do të rikthehen ndeshjet e javës së 24 në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë së Veriut. Skuadra e FC Shkupit do të jetë nikoqire në Çair, ku do të pret ekipin e Makedonija Gj.P. Për ndeshjen ka folur mbrojtësi Amir Biliali, i cili ka vlerësuar pauzën dy javore dhe se ekipi ka stërvitur i plotë për ndeshjet në vazhdim. "Kemi pushuar mjaft pasi nuk ka pasur ndeshje kampionale, mirëpo kjo na ka ndihmuar për tu stërvitur dhe kemi punuar shumë mirë me gjithë futbollistët dhe besoj se jemi gati për ndeshjen e radhës dhe për ato tri të tjera, pasi për 10 ditë kemi 4 ndeshje. Jemi gati për të dhënë më të mirën në fushë. Nuk mendojmë për asnjë kundërshtarë dhe ne do të futemi në fushë, pasi lozim në shtëpi, do të japim më të mirën për të dal në fund me rezultat pozitiv edhe ashtu besoj do të jetë", deklaroi Amir Bilali. Trajneri Umit Karan për ndeshjen e radhës do të ketë të gjithë futbollistët në dispozicion, ndërsa i vetmi që mbetet jashtë ekipit është Ergin Abdul. Lajm i mirë për ekipin bardheblu është se rikthehet nga lëndimi kapiteni Muharem Bajrami, ndërsa gjithashtu ka kaluar dënimin e pesë kartonëve të verdhë edhe Suhejl Muharemi. Nga ana tjetër skuadra e Shkëndijës do të udhëtojë drejt qytetit të Kratovës, ku do të luaj me Sileksit. "Kuqëzinjtë" në pesë takimet e fundit si mysafire e Sileksit ka arritur katër fitore dhe një kanë barazuar. Ndërkaq, edhe në takime e së enjtes (sot) kërkojnë që në Tetovë, të kthehen me tre pikët duke u afruar edhe më afër titullit të tret kampion. Trajneri, Qatip Osmani ka theksuar se djelmoshat e tij janë të përgatit maksimalisht për këtë përballje, dhe se do të mirën nga vetja që në Tetovë të kthehen me tre pikët. "Rikthehemi pas pauzës shkaku i ndeshjeve ndërkombëtare dhe na pret transferua me Sileksin në Kratovë. Mendoj që pauza na ka bërë mirë për të pushuar dhe më pas për të kërkuar që të akumulojmë forcë dhe energji për sfidat e radhës. Sileksi nuk është në pozitë të mirë në renditje, por ne kemi respekt maksimal për ta si për gjithë skuadrat tjera dimë që deri te tre pikët mund të arrijmë vetëm nëse japim më të mirën në fushë. Besoj që lojtarët kanë kuptuar atë se çka kërkohet nga ata, shkojmë në Kratovë të japim më të mirën nga vetja, dhe opsioni jonë mbetët vetëm fitorja. Për këtë duhet shumë mund por un besoj se djemt e mi do të menaxhojnë si duhet këtë përballje", tha Qatip Osmani. Në përballjet tjera, ndeshje interesante do të zhvillohet në stadiumin "Filipi i Dytë", ku do të luhet derbi i qyteti mes skuadrës së Rabotniçkit dhe Vardarit. Skuadra e Rabotniçkit në këtë takim hyn pas dy humbjeve në kampionat, ndërsa shpresojnë se pikërisht në takimin derbi do të arrijnë të dalin nga kjo minikrizë. Në stadiumin e qytetit në Tetovë, skuadra e Renovës do të jetë nikoqire e Bellasicës. Xhepçishtasit në pesë takimet e zhvilluara në sezonin pranveror ende nuk kanë pësuar disfatë, ndërsa besojnë se edhe ndaj Bellasicës do të marrin rezultat pozitiv. Të gjitha ndeshjet të të luhen të enjten (sot) me fillim prej ora 14:30.



Kloppi me lajm të mirë për Shaqirin

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, i ka gëzuar tifozët e Xherdan Shaqirit, pasi ky i fundit u largua nga kampi i Zvicrës për shkak të një lëndimi. Xherdan Shaqiri nuk mori pjesë në ndeshjet e këtij muaji të ekipit kombëtar të Zvicrës, pasi që u përball me disa probleme me ijën e tij. Megjithatë, Kloppi ka bërë të ditur se Shaqiri është në gjendje shumë më të mirë tani dhe beson se do të jetë i gatshëm për ndeshjen e fundjavës. "Ai është mirë, shumë më mirë. Shaqiri, që prej dy javësh, ka pasur disa probleme me ijën e tij. Ai është stërvitur, jo në maksimumin e tij, por ishte prapëseprapë pjesë e skuadrës sepse ne nuk kishim shumë opsione", ka bërë të ditur Kloppi. "Tani, ai po ndihet gjithmonë e më mirë dhe duhet të jetë në rregull për fundjavë". Të dielën, Liverpooli do të ndeshet me Tottenhamin, në kuadër të Premierligës, dhe deklarata e Kloppit i rrit gjasat që Shaqiri të jetë i përfshirë në këtë ndeshje. Gjatë kohës së fundit, që nga fillimi i vitit të ri, roli i Shaqirit në skuadrën e Liverpoolit është zvogëluar shumë dhe dukej se Kloppi e kishte humbur besimin te përfaqësuesi zviceran. Ndeshja e fundit si titullar për Shaqirin ishte në janar, një nga vetëm dy ndeshjet që i ka filluar nga minuta e parë këtë vit. Që nga atëherë, ai ka luajtur vetëm 40 minuta, duke u inkuadruar në dy ndeshje si zëvendësues. Shaqiri nuk ka luajtur fare në katër ndeshjet e fundit të Liverpoolit.

Ujkani: Dashuria e "Dardanëve" na bën më të fortë

Kapiteni i Kosovës Ujkani, i ka falënderuar tifozët "Dardanët" për mbështetjen e tyre gjatë ndeshjeve të ekipit kombëtar të Kosovës. Portieri i ekipit të Kosovës, Samir Ujkani, e ka shfrytëzuar llogarinë e tij në rrjetin social Instagram për t'i falënderuar "Dardanët për mbështetjen e dhënë gjatë ndeshjeve. "Dashuria juaj na bën më të fortë. Gjithmonë të bashkuar", shkruan Ujkani në llogarinë e tij në Instagram. Ujkani e ka publikuar në llogarinë e tij një fotografi nga koreografia e përgatitur nga "Dardanët" për ndeshjen kundër Bullgarisë. "Dream on Dardanians" (shqip "Vazhdoni të ëndërronë Dardanë") shkruhej në koreografinë e tifozëve të Kosovës. Pasi që Ujkani nuk luajti në ndeshjen kundër Bullgarisë, pasi Arijanet Murici e mori pozitën e portierit të parë, Hekuran Kryeziu e mbajti shiritin e kapitenin për barazimin 1:1 me Bullgarinë, në ndeshjen e zhvilluar në kuadër të Grupit A për kualifikime për EURO 2020. Ujkani nuk kishte qenë titullar as në ndeshjen tjetër të Kosovës këtë muaj, kundër Danimarkës. Megjithatë, në atë ndeshje, që përfundoi me rezultat 2:2, Ujkani luajti për 45 minutat e pjesës së dytë.

Maqedonia U19 me fitore dhe barazim në dy testet me Shqipërinë

Shkup, 27 mars - Përfaqësuesja U19 e Maqedonisë ka shënuar fitore dhe barazim në takimet miqësore me Shqipërinë U19 të zhvilluara në Korçë dhe Ohër. Ndeshja e parë në Korçë u mbyll baraz 1:1. Dimitar Todorovski shënoi për epërsi të Maqedonisë U19, ndërsa Armando Broja barazoi në pjesën e dytë. Ndërkohë në terren vendas në Ohër shpresat e vendit fituan 2:1. Jeton Dauti dhe Agon Elezi realizuan për Maqedoninë U19, duke përmbysur pas epërsisë së Shqipërisë 19' që avansoi me anë të Brojës në minutën e nëntë. Pas dy testeve me Shqipërinë, seleksionuesi i Maqedonisë U19 Goran Staniq është shprehur i kënaqur me performansën e skuadrës. "Jam i kënaqur me qasjen e futbollistëve dhe mënyrën si zhvilluam këto dy ndeshje. Kemi treguar pjekuri në lojë dhe me meritë kemi shënuar fitore në takimin e dytë edhe pse nuk do të ishte e pamerituar edhe nëse fitonim në Korçë. Shqipëria ka përfaqësuese të fortë, me shumë lojtarë që luajnë jashta vendit, mirëpo ne gjithsesi ne ishim në nivel të

detyrës. Me lojë të disiplinuar dhe pa frikë në duele vlerësoj se ishim në nivel", deklaroi seleksionuesi i Maqedonisë U19, Goran Staniq.

KOMUNA E ÇAIRIT ОПШТИНА ЧАИР

KRYETARI I KOMUNËS
Bul. Hristijan T. Karposh Nr. 5
Tel: 02/2616-860 | faks: 02/2616-867
info@cair.gov.mk | www.cair.gov.mk

Nr. _____ prej _____

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Çairit, e solli këtë:

L A J M Ë R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik të territorit të Komunës së Çairit se shpallet

Thirrje publike për dorëzimin e iniciativës për përpilim të Planeve urbanistike

Thirrja publike shpallet në pajtueshmëri me nenin 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), **në kuartalin e parë të vitit 2019.**

- **Thirrja publike do të zgjasë prej 02.04.2019 deri më 01.05.2019 - 30 ditë**, duke llogaritur nga dita e shpalljes.

- **Thirrjes publike** do të shpallet në Fletën zyrtare të Komunës, në internet faqen e Komunës së Çairit www.cair.gov.mk, në tabelën e shpalljeve në komunë, në sistemin informativ e-urbanizëm, në gazetën ditore në gjuhën maqedonase "NOVA MAKEDONIJA" dhe gazetën ditore në gjuhën shqipe "KOHA".

- Në periudhë e zgjatjes së Thirrjes publike, të gjithë personat e interesuar fizik dhe juridik të dorëzojnë iniciativa për përpilimin e Planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18).
- Personat e interesuar juridik dhe fizik iniciativat ti dorëzojnë në formë të shkruar nëpërmjet arkivit të Komunës së Çairit ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e caktuar.

- Lëndë e iniciativës mund të jetë miratimi i Planit të ri urbanistik ose ndryshim plotësimi i planit ekzistues urbanistik.
- Për iniciativat e pranuara parashtruesit do të informohen në formë të shkruar ose në formë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afat prej 15 dite nga skadimi i afatit për dorëzimin e iniciativave.
- Iniciativat e pranuara nga Thirrja publike do të shënohen në Ndryshim dhe plotësim i Programin për përpilim të Planeve urbanistike të territorit të Komunës së Çairit për vitin 2019.
- Mjetet për përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm për iniciativat e pranuara duhet ti sigurojnë parashtruesit e iniciativave – persona juridik ose fizik.

përpiloi: T.S.
miratoi: Xh.H.

Kryetar i Komunës së Çairit
Visar Ganiu

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16,163/16, 64/18, 168/18) dhe Vendim me nr. 10-825/1 nga 12.03.2019 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

K O M U N I K A T Ë

për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike për Dokumentacionin urbanistik planor lokal për P.K. nr. 2596, K.K. Reçicë e Vogël r.nd. v.q. Keramidnicë, me destinim B1-Destinime komerciale dhe afariste të vogla, komuna e Tetovës

Njoftohen qytetarët e komunës së Tetovës se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike sipas **Dokumentacionit urbanistik planor lokal për P.K. nr. 2596, K.K. Reçicë e Vogël r.nd. v.q. Keramidnicë, me destinim B1-Destinime komerciale dhe afariste të vogla, komuna e Tetovës i përpunuar nga "PROINZHENERING"- SHPK Tetovë, me nr. tek. 04-25/2017.**
Lënda e përfshirjes planore është i locuar në territorin e komunës së Tetovës.
Parcela kadastrale PK 2596 që gjendet jashtë përfshirjes planore të dokumentacionit planor urbanistik ekzistues të PGJU-së për qytetin e Tetovës dhe PUFSH fsh. Reçicë të Vogël. Parcela kadastrale PK 2596 nga kufiri veri-perëndimor kufizohet me PK 2573/2, në anën veri-lindor me rrugën ekzistuese "172", nga ana juglindore me PK 2599 dhe nga kufijtë anësorë jugperëndimor me PK 2574/1.
Përfshirja është me sipërfaqe prej **1404** m^2.

ANKETA PUBLIKE sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për P.K. nr. 2596, K.K. Reçicë e Vogël r.nd. v.q. Keramidnicë, me destinim B1-Destinime komerciale dhe afariste të vogla, komuna e Tetovës do të zgjatë 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 03.04.2019 – 09.04.2019.

PREZANTIMI PUBLIK sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për P.K. nr. 2596, K.K. Reçicë e Vogël r.nd. v.q. Keramidnicë, me destinim B1-Destinime komerciale dhe afariste të vogla, komuna e Tetovës, do të mbahet me dt. **04.04.2019** në ora 11:00, në zyrën nr.20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Listat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr.20 në komunën e Tetovës ose në formën elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë me planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Shtojca grafike e Dokumentacionit urbanistik planor lokal për P.K. nr. 2596, K.K. Reçicë e Vogël r.nd. v.q. Keramidnicë, me destinim B1- Destinime komerciale dhe afariste të vogla do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës në veb faqen e komunës, informata më detale për Dokumentacionin urbanistik planor lokal do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

Komuna e Kumanovës

Vetëqeverisje lokale

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Kumanovës e solli këtë

LAJMËRIM

Lajmërohet të gjithë subjektet fizike dhe juridike të territorit të Komunës së Kumanovës që publikohet

Thirrje publike për parashtrim të iniciativave për përpunim të Planeve urbanistike

Thirrja publike botohet sipas nenit 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), në kuartetin e parë të vitit 2019.

- **Thirrja publike do të zgjas nga data 28.03.2019 deri më 30.04.2019 - 34 ditë** llogaritur me ditën e publikimit.
- **Thirrja publike do të botohet** në fletën zyrtare të komunës, në ueb faqen e komunës www.kumanovo.gov.mk , në tabelën e shpalljeve të komunës, në sistemin informativ e-urbanizëm, në gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe gazetë ditore në gjuhën shqipe.
- **Gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes publike** të gjithë subjektet fizike dhe juridike të interesuar mund të parashtrojnë iniciativë për përpunim dhe sjellje të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika 2 alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18).
- **Lëndë e iniciativës** mund të jetë sjellja e planit të ri urbanistik ose ndryshim dhe plotësim të planit urbanistik ekzistues **me shpjegim për ndryshimin e kërkuar** dhe propozim të përfshirjes planore nga parashtruesi i iniciativës.
- **Subjektet juridike dhe fizike të interesuar**, iniciativat mund t`i parashtrojnë personalisht sipas nenit 21 paragrafi (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18).
- **Mjetet për iniciativat e pranuara** për përpunim të dokumentacionit të duhur duhet të sigurohen **nga vet parashtruesit e iniciativave.**

Nr. 21-2136/1

Kryetari i komunës së Kumanovës

Data 26.03.2019 **Maksim Dimitrievski**

NBA

ANTETOKOUNMPO MPOSHT HARDEN, KEMBA WALKER U JEP FITOREN HORNETS

U luajtën plot 10 ndeshje në NBA, ku interes të veçantë kishte përballja mes dy kandidatëve për çmimin e MVP të sezonit të rregullt, James Harden e Giannis Antetokounmpo. Në fakt, të dy shkëlqyen në përplasjen mes Houstonit dhe Milwaukee, por në fund festoi "ylli" i Bucks me rezultatin përfundimtar 108-94. 19 pikë dhe 14 "rebound" realizoi basketbollisti grek, ndërsa rivali i tij i Rockets shënoi 23 pikë, aq sa Eric Bledsoe shtoi për Bucks. Vetëm një sfidë përfundoi në kohën shtesë, pikërisht ajo mes Charlotte Hornets dhe San Antonio Spurs 125-116. Në fund të periodës së katërt, dy herë DeRozan dhe një herë tjetër Walker gabuan në tentativën që do t'u jepte fitoren skuadrave respektive, ndërsa në kohën shtesë Kemba Walker, me 38 pikë në total, bëri diferencën mbi parket. Duhet veçuar edhe forma e mirë e Dwayne Bacon, që shtoi 24 pikë të tjera për Hornets. Nuk mjaftoi "triple-double" i Luka Doncic (28 pikë, 12 aiste dhe 12 "rebound") për të çuar te suksesi Dallas Mavericks ndaj Sacramento Kings, me të zotët e shtëpisë që në fund u dorëzuan 121-125. De'Aaron Fox me 23 pikë e Buddy Hield (17) siguruan në finale fitoren e Kings. Ndërkohë, Los Angeles Lakers, që nuk kanë më mundësi për ta përfunduar sezonin në zonën play off, mposhtën 124–106 Washington Wizards. 23 pikë dhe 14 asite për Lebron James, por më i miri për kalifornianët rezultoi Kentavious Caldwell-Pope me 29 pikë. Nuk mjaftoi për Wizards paraqitja shumë e mirë e Bradley Beal, që pavaërisht se realizoi 32 pikë, në fund nuk kishte të drejtën për të festuar. Dështojnë në transfertë 95 – 92 në sfidën shumë të rëndësishme për zonën play off Detroit Pistons. Rezultoi përcaktues me 33 pikë pikë Jamal Murray, por edhe Nikola Jokic me 23 pikë e 15 "rebound". Vlejtën vetëm për statistikë 29 pikët dhe 15 topat e kontrolluar nga Blake Griffin.

Mercedes: Në Bahrein do të luajmë rolin e sfidantit

Në Australi, gara e parë sezonale e Botërorit 2019 në Formula 1, u mbyll me një triumf të dyfishtë të Mercedes. Bottas e Hamilton zunë dy vendet e para dhe finlandezi realizoi xhiron më të shpejtë. Pavarësisht kësaj, Toto Wolff, shefi i Mercedes, mendon se gara e radhës, në Bahrein, nuk e sheh aspak makinën gjermane si favorite. "Sezoni sapo ka nisur, Ferrari do të bëjë gjithçka për të fituar në Bahrein dhe Red Bull tregoi se mund të duelojë për fitore. Ne e pamë forcën e "kokëkuqes" gjatë testeve dhe pavarësisht paraqitjes së mirë në Australi, në Bahrein nuk jemi favoritë. Një garë e vetme nuk vendos fatin e gjithë sezonit", tha Wolff. Ashtu si Australia edhe Bahrein ëhstë një pistë mikse, mes një gare qytetase dhe një piste tradicionale. Gara në shkretëtirë ka shumë të papritura, që vijnë kjryesisht nga orari i garës dhe ku temperaturat ndryshojnë shpejt. "Është një histori më vete, ku temperatura ndryshon nga njëri session në tjetrin. Ky është faktor i rëndësishëm, që të pengon për të patur një makinë të qëndrueshme", tha Wolff.

Publicitet

KOMUNA E ÇAIRIT / ОПШТИНА ЧАИР

KRYETARI I KOMUNËS

Nr. _____ prej _____.

Kryetari i Komunës së Çairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga, **Veli Marovci** nga Shkupi, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 7" nr. 7, e dorëzuar me numër 08-1351 të datës 15.04.2011, në bazë të nenit 21, paragrafi (2), të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr.199/14, nr. 124/15, 129/15, 271/15, 31/16 dhe 190/17) e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209 nga Ligji për procedurë të përgjithshme juridike ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/2005 110/08 dhe nr.51/2011), e miraton këtë:

A K T V E N D I M
për përcaktimin e statusit juridik të objektit
të paligjshëm

1. Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm; **shtëpi banimi,** që gjendet, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 7" nr. 7, Shkup, PK 1949KK Çair, e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 1841, objekt i cili është shënuar si:
numri i objektit **3,** Përdhese, hyrja 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **banim**, sipërfaqja e brendshme **47 m²**.
numri i objektit **3,** Kati 1, hyrja 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **banim**, sipërfaqja e brendshme **48 m²**.
numri i objektit **3,** Nënkulm, hyrja 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **banim**, sipërfaqja e brendshme **50 m²**.

2. Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet, **Veli Marovci** nga Shkupi, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 7" nr. 7, me letërnjoftim nr:G0073177.

3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborati gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr.11/1402 të datës06.04.2011,i përpiluar nga "ALFA GEODET" SHPKNJP-Shkup.
4.Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

A r s y e t i m

Kërkuesi **Veli Marovci** nga Shkupi, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 7" nr. 7, dorëzoi kërkesë me numër 08-1351 të datës 15.04.2011, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm: **shtëpi banimi,** që gjendet, rr. "Brigada Maqedonase Kosovare 7" nr. 7, Shkup, PK 1949KK Çair, e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 1841, me gjithsej sipërfaqe të brendshme **145** m2

Kërkuesi me kërkesën parashtroi:
-Elaborat gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr.11/1402 të datës 06.04.2011,i përpiluar nga "ALFA GEODET" SHPKNJP - Shkup.
- Fotokopje e letërnjoftimit
- Faturë nga shërbimet publike
-Akt noteri- Deklaratë nr. PLA 221/2019 në Shkup të datës 31.01.2019
- Vërtetim për pasqyrë historike për regjistrimet e realizuara për PK 1949 KK Çair me nr. 1107-617/2019 të datës 05.02.2019
Gjatë procedurës janë sjellë këto:
- Procesverbal nga këqyrja në vend me nr. 08-1351 të datës 01.02.2012
- Pëlqim urbanistik me nr.08-1351 të datës 08.02.2019
- Konkluzion për pagim të kompensimit nr.08-1351 të datës 12.02.2019

Trualli në të cilën është ndërtuar objekti është në pronësi të RM.
Dedikimi i objektit të paligjshëm është i banimit, ndërsa në pajtim me dokumentacion e planit urbanistik në fuqi në tokën e të lartpërmendurës PK 1949 KK Çair, në të cilën është ndërtuar objekti është parashikuar zonë për banim me dedikime të kombinuara.

Konstatohet se janë plotësuar kushte për përputhje të objektit të ndërtuar në mënyrë të paligjshëm në dokumentacionin e planit urbanistik në pajtim me standardet për përputhjet të objekteve të ndërtuar në mënyrë të paligjshëm në dokumentacionin e planit urbanistik.

Kryetari i Komunës së Çairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pajtueshmërinë urbanistike, konstaton se janë përmbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm.
Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Çairit për përcaktimin e statutit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statutit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit ë aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës.

Ankesa taksohet me taksë administrative në shumë prej 250,00 denarëve.
Dorëzuar deri te:
- Kërkuesi
- Arkivi
Miratoi - E.A.
Përktheu – L.R

Kryetar
Visar Ganiu

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Në bazë të nenit 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme, nr.07-9992/3 të datës 05.06.2014, Komisioni për realizim të procedurës për grumbullim të ofertave për zgjedhje të subjektit juridik për realizim të ekskursionit shkollor, publikon:

T H I R R J E
(PËR DORËZIM TË OFERTAVE PËR REALIZIM TË EKSKURSIONIT SHUMËDITOR)

1. Përshkrimi i shërbimit
- Në ekskursionin shkollor do të marrin pjesë 28 nxënës dhe 4 profesorë gjegjësisht gjithsej 32 pjesëmarrës, subjekti juridik i cili do të konkurrojë për realizim të ekskursionit shumëditor duhet ta ketë parasysh që ekskursioni pesëditor (4+1) është i paraparë të realizohet në relacionin (Rostushe - Qafëthanë - Elbasan - Vlorë - Berat - Durrës - Tiranë - Krujë - Lezhë - Shëngjin - Shkodër - Prishtinë - Rostushe), mjetet transportuese duhet të jenë komforte dhe të klimatizuar me ulëse të sigurt për çdo nxënës të ekskursionit si dhe oferta të përfshijë 4 pansione të plota dhe mbrëmje argëtuese.
2. Subjekti juridik i cili do të konkurrojë për realizimin e ekskursionit shumëditor duhet t`i plotësojë kushtet minimale sipas nenit 21 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme, nr.07-9992/3 të datës 05.06.2014 edhe atë:
- Të jetë i regjistruar sipas dispozitave pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë turistike përkatëse, të ketë realizuar me sukses së paku 3 ekskursione të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit, t`i plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve sipas Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregullores për kërkesat e veçanta teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.
3. Dokumentet të cilat duhet t`i dorëzojë ofertuesi:
- Dëshmi që është i regjistruar sipas dispozitave pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë turistike përkatëse, dëshmi që ka realizuar së paku 3 ekskursione të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit, dëshmi që i plotëson kushtet për transport të grupeve të fëmijëve sipas Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregullores për kërkesat e veçanta teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.
4. Me ofertën subjekti juridik duhet të dorëzojë edhe garanci bankare për realizim kualitativ të marrëveshjes në shumën prej 5% të vlerës së marrëveshjes gjegjësisht ofertës.
5. Afati përfundimtar për dorëzim të ofertave është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes në gazetë ditore.

Subjekti juridik i cili do të konkurrojë për realizim të ekskursionit shumëditor është i detyruar që dokumentet-ofertën ta parashtrojë në këtë mënyrë:

- në zarf të mbyllur me shenjën "PËR EKSKURISONIN SHUMËDITOR" t`i parashtrojë në arkivin e SHMK "Mavrovë-Rostushe" - Rostushe ose përmes postës në adresën në vijim:

SHMK "Mavrovë-Rostushe" - Rostushe 1254 f.Rostushe
Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara me vonesë nuk do të shqyrtohen.

SHMK "MAVROVË-ROSTUSHE" - ROSTUSHE
Komisioni për realizim të
procedurës për grumbullim të ofertave

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Njoftim
Universiteti i Evropës Juglindore shpall thirrje publike për sa vijon:
- **Thirrje publike nr. 01/032019 - Furnizim me energji elektrike**

Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata më të hollësishme në:
www.seeu.edu.mk/sq/information/tenders

S H P A L L J E

Shitet tokë në Vizbegë e cila gjendet në PK 602 Vendi quajtur RAMNISHTE me siperfaqe prej 1558 m2, e regjistruar në Fletë Pronësi nr. 2358 për KK vIYBEGË, në bashkëpronësi të Isuf Amati.
Ofertat e tyre mundë ti paraqesin në zyrën e Noterit Naser Zyberit, rr. Xhon Kenedi nr. 9A, Shkup.

E VËRTETON EDHE SHKENCA: MESSI ËSHTË LOJTARI MË I MIRË NË BOTË!

"Derisa ai është gjallë, është vetëm një – Lionel Messi. Nëse ju thoni se dikush tjetër është lojtari më i mirë në botë, Messi e ka thyer këmbën qe një vit, është i vdekur ose jeni duke gënjyer", ka thënë Brundish

Tashmë nuk ka dilema, edhe shkenca e ka vërtetuar se Lionel Messi është përpara të gjithëve. Ylli argjentinas ka statistika impresionuese. Lideri i shkencës sportive, Simon Brundish e ka dhënë pikëpamjen e tij kur është pyetur se kush është futbollisti më i mirë në botë. Ai nuk kishte dyshime kur bëhet fjalë për lojtarin më të mirë të planetit. "Derisa ai është gjallë, është vetëm një – Lionel Messi", ka thënë Brundish. "Nëse ju thoni se dikush tjetër është lojtari më i mirë në botë, Messi e ka thyer këmbën qe një vit, është i vdekur ose jeni duke gënjyer", ka shtuar ai. Messi konsiderohet si njëri prej lojtarëve më të mirë të të gjitha kohëve, prandaj nuk ka shumë dyshime sa i përket lojtarit më të mirë të momentit në botë. Mirëpo, Brundish e ka një set statistikash, për të cilat mendon se janë të mjaftueshme për t'i dhënë fund debatit në fjalë. "Momentalisht Messi e shënon një gol ose e jep një asistim çdo 48 minuta", shpjegon ai. "Nëse e mendojmë se një ndeshje zgjat deri në 95 minuta (përfshirë këtu edhe kohën kur ka lëndime), do të thotë se ai shënon ose asiston dy herë brenda një loje", shton Brundish. Messi ka qenë gjithmonë i ndjekur nga Cristiano Ronaldo, i cili ka po ashtu statistika impresionuese. Mirpëo, Messi është përpara të gjithëve, edhe pse lojtarët tjerë si Luis Suarez, Neymar, Kylian Mbappe e Mohamed Salah kishin po ashtu statistika të jashtëzakonshme të shënimit të golave për klubet dhe kombëtaret respektive. Brundish ndër të tjera thotë se dominimi i Messit nuk ka të bëjë vetëm me shënimin e golave, por ai gjithashtu renditet lart edhe në statistikat e njohura si "xG-Build". Ky matës e poenton çdo lojtar të përfshirë në gol, përpos lojtarit që e bën pasimin final (asistimin) dhe shënuesin e golit. Për shembull, nëse portieri e nis pasimin deri tek mbrojtësi, i cili më pas e luan topin për tek mesfushori ofanziv, para se t'ia japë topin shënuesit të golit, portieri dhe mbrojtësi mund të fitojnë pikë në këto statistika në sistemin "xG-Build". Duke e pasur parasysh se Messi zakonisht është asistues ose shënues, është e qartë dhe e logjikshme se ai është prapa lojtarëve të tjerë sa i përket "xG-Build", të cilët kanë më shumë detyrë për ta ndërtuar nga fillimi aksionin për të shkuar deri tek goli dhe për shkak të pozitës së tyre më prapa në fushën e blertë. Mirëpo, kjo nuk e ka penguar Messin që po ashtu të jetë prezent edhe në këtë rast. Duke i përdorur statistikat e sezonit të plotë 2017-18 nga sajti i statistikave të futbollit, "Understat", Messi ka qenë prezent në pozita mjaft të larta në "xG-build" në krahasim me "plejmekerët" më të mirë të botë si Eden Hazard i Chelseat, Mesut Ozil i Arsenalit dhe Christian Eriksen i Tottenhamit. Pesë herë fituesi i Topit të Artë i ka lënë prapa edhe lojtarët e mëdhenj si Ronaldo, Salah e Neymar. Messi është nga një tjetër planet, definitivisht.



Raiola i vendos çmimin Pogbas

Mino Raiola ende po punon t'i gjejë një klub të ri Paul Pogba. Menaxheri i mesfushorit të Manchester United tashmë ka nisur kontaktet me klubet e interesuara, veçanërisht me Real Madridin, duke pasur parasysh se kush mund t'iu afrohet pretendimeve ekonomike të lojtarit të tij. Kështu shkruan "Tuttosport". Kampioni i botës me Francën synon një rrogë prej 16 milionë euro (neto) në sezon, një shifër që do të thyente "rekordin" aktual të pagave tek ekipi i bardhë. Nëse palët gjejnë marrëveshje, Pogba do të bëhej lojtari më i paguar në Madrid, përpara Gareth Bale (14 milionë euro në sezon) dhe Sergio Ramos (11 milionë). Aktualisht, francezi merr 10 milionë euro në "Old Trafford", të cilave duhet t'iu shtojmë edhe 5 milionë të tjera, që vijnë nga të drejtat e imazhit. Raiola synon transferimin e radhës të klientit të tij, sepse përfiton shumë edhe vetë në këso rastesh, duke hyrë në bisedime me Real Madridin. Për menaxherin e mirënjohur të futbollit, kushdo që dëshiron Pogba, duhet të vendosë në tavolinë së paku 16 milionë euro pagë për lojtarin.

NJË VIT PËRPJEKJE, ZBARDHET SKENARI I PEREZ PËR MBAPPE

Për shkak të situatës së Real Madridit, tashmë janë shumë emra yjesh, që tingëllojnë bukur për ekipin e bardhë. Cili do të jetë lojtari i ardhshëm, i zgjedhur për të zëvendësuar CR7 dhe fituar përsëri në "Santiago Bernabeu"? Kjo është pyetja e madhe, që bëjnë tifozët e Real Madridit. "Los Blancos" janë të etur të takojnë "heroin" e tyre të ardhshëm. Megjithëse përflitet shumë Eden Hazard, mbretërorët madrilenë ëndërrojnë mbërritjen e Kylian Mbappé. Sipas "Le Parisien", tashmë mund të jetë planifikuar një datë për largimin e talentit francez nga "Parce des Princes". Kostoja e lojtarit, koha e tij e paktë te PSG dhe mosha e kampionit të botës janë faktorët kryesorë, që ndikojnë në këtë operacion. Për këtë arsye, Mbappé nuk pritet të bashkohet me Real Madridin këtë verë, por në merkaton e ngjashme të vitit 2020. Florentino Perez do të përpiqet ta zvogëlojë shumën që duhet të paguajë për Mbappe, duke përfshirë në operacion nisjen paraprake të James Rodriguez dhe Isco Alarcón tek ekipi parizien. Shifra prej 280 milionë eurosh, që do ta bënte atë lojtarin më të shtrenjtë në histori, është tepër e lartë për t'u paguar më 2019. Mediat franceze "kafshojnë thonjtë", duke besuar se rikthimi i Zinedine Zidane në stolin e të bardhëve mund të jetë me ndikim të madh në këtë transferim. Sipas tyre, Florentino Perez do të ketë një vit të tërë në dispozicion, në përpjekje për ta marrë Mbappé nga PSG.

Publicitet

DASHI 21. mars - 20. prill

Venusi do ju garantoje një klime shume te ngrohte sot juve qe jeni ne një lidhje. Do ndiheni me te sigurt pranë partnerit tuaj dhe emocionet do shumëfishohen. Beqaret do kenë momente mjaft intensive dhe do arrijnë te njohën me persona vërtet mbresëlënës. Ata do ua ndryshojnë jetën për mire kështu qe përfitoni. Me financat duhet te jeni shume me te arsyeshëm

DEMI 21. prill - 21. maj

Lërini gjerat te rrjedhin vete sot dhe jetojeni jetën si t'iu vije. Partneri tregohet i dashur dhe nuk do ua prishe për asgjë. Do ndiheni vërtet me fat qe e keni atë pranë. Beqaret me ne fund do ndihen te përmbushur pas takimit qe do realizojnë. Sot për ta do rilinde shpresa. Te ardhurat do fillojnë te përmirësohen dhe kjo do ju lejoje te bëni ndonjë investim me tepër se zakonisht.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Ata qe janë ne një lidhje ka rrezik te kenë mosmarrëveshje sot dhe mund te arrijnë te mendojnë edhe një shkëputje te përkohshme. Për çdo hap duhet patjetër te bien ne konsensus me atë qe kane ne krah. Beqaret do pushtohen nga euforia dhe mund te hedhin hapa goxha te rëndësishme. Për financat ka për te qene një nga ditët me te mira dhe do ndiheni te qete kur te shpenzoni.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Venusi do e favorizoje jashtë mase jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Do jeni shume te drejtpërdrejtë me partnerin dhe do dini te merreni vesh për gjithçka me te. Beqaret do kenë një dite interesante, por nuk do ndihen ende gati për te filluar lidhje. Për buxhetin nuk duhet te shqetësoheni pasi Neptuni do arrije t'i mbaje financat te stabilizuara. Nuk do keni asnjë lloj problemi.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do dini si të silleni si duhet me partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe shume nga dëshirat qe keni pasur do ju plotësohen. Ai do jete pafundësisht i ëmbël dhe romantik. Për beqaret gjithashtu pritet një klime e ngrohte dhe mjaft emocionuese. Edhe për ta gjerat do jene me ndryshe. Buxheti nuk do jete i shkëlqyer megjithatë disi me i mire se disa dite me pare.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Nëse jeta juaj ne çift ka kohe qe ka probleme te vogla, sot është momenti te sqaroni gjithçka për te qene me te qete. Pranojini edhe gabimet e vogla qe keni bere vete dhe mos ua hidhi përherë fajin te tjerëve. Beqaret tani për tani do preferojnë vetëm te bëjnë miq dhe jo te fillojnë menjëherë një lidhje. Ne planin financiar do keni mbështetje nga te afërmit dhe nuk do gjendeni ne vështirësi.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dielli do e favorizoje mjaft jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Si ju ashtu edhe partneri do përkujdeseni gjithë kohës për atë qe keni ne krah. Beqaret me ne fund do realizojnë një takim qe do i beje te ëndërrojnë dhe ta shohin boten ndryshe. Edhe ne planin financiar do jeni me fat. Do arrini t'i shlyeni te gjitha borxhet qe keni pasur dhe mund te kryeni disa shpenzime me tepër.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Do jeni me shprehës sot ju te dashuruarit dhe do krijoni një atmosfere te mrekullueshme ne çift. Partneri nuk do ketë për çfarë te qahet. Beqaret do fillojnë aventura kalimtare. Për ta janë me te rëndësishme emocionet e momentit dhe nuk mendojnë për te nesërmen. Ne planin financiar yjet do ndikojnë pozitivisht dhe gjendja do jete goxha e mire.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Jeta juaj ne çift do jete e mbushur me momente te lumtura sot. Do përjetoni kënaqësi te njëpasnjëshme dhe nuk do doni te ndaheni për asnjë moment nga partneri. Beqaret do jene ne humor te mire dhe gati edhe për ndonjë aventure te çmendur. Me shpenzimet duhet te tregoheni patjetër te matur pasi nëse nuk e bëni këtë mund te shpenzoni edhe qindarkën e fundit.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Partneri do jete i gatshëm t'ua plotësojë çdo dëshirë sot juve qe jeni ne një lidhje edhe sikur ta teproni. Shprehni çdo gjë qe doni sepse rralle here vijnë dite te tilla. Beqaret nuk do kenë kuraje t'ia shprehin pëlqimin dikujt dhe do vazhdojnë te mbeten te vetmuar. Klima yjore do jete e turbullt për financat. Mbajini sa me shume nen kontroll qe te mos keni probleme.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do keni ndjenja edhe me te thella sot ju te dashuruarit dhe kjo do e forcoje akoma me tepër lidhjen tuaj. Çdo çast ka për te qene fantastik. Beqaret do jene me kërkues nga sa duhet dhe nuk kane për te gjetur persona ashtu siç i ëndërrojnë. Financat nuk do jene te këqija, megjithatë papritur do ndodhe diçka qe do ju mahnite dhe do ua përmirësoje buxhetin ndjeshëm.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dite shume e paqëndrueshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Shpesh do ndiheni keq dhe do doni t'i jepni fund gjithckaje, por ne fakt kjo nuk do ishte zgjedhja e duhur. Beqaret do jene më me fat ne dashuri dhe me shume gjase do takojnë personin e ëndrrave. Buxhetin do e menaxhoni me kujdes kështu qe nuk do ju dalin te papritura te pakëndshme.

						ACID ORGANIK QË GJENDET TE MUSKUJT (SH.)	K	NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO	ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ NË FOTO	BANORJA E SHTETIT MË TË MADH POR ME PAK TË BANUAR TË SHBA-VE
						KRYEMINISTRI, EDI				
						PARLAMENTARIA JONË, UZEIRI / QYTET NË IRAK				
						B				
						HERO I STRIPAVE, VILER / PIP I VOGËL I SAPODALË DRURI				
						P				
						ISH FUTBOLLISTI ITALIAN, STEFANO / ZONË E NJOHUR E NJU JORKUT				
Mensur Mamuti	BASKETBOLLISTI BRAJANT	NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO (SOT, DREJTOR I KLUBIT)	MISIONARI BEKTASHIAN I TEQESË HARABATI, ALI DEDE (SHQ.)	THE RED CHORD	BEND AMERIKAN I HARD ROKUT, VAN / RUMANIA					
KOMUNË NË MALËSISNË E MADHE TË SHQIPËRISË / PORTIERI GJERMAN, MANUEL								RIMINI / NËNË (KRAHIN.)		
N					REOMIRI / E LIND SËRISH		LIDHËZ, POR / NËPUNËS SHTETËROR			
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO										ME TRUP TË IMËT
E PANJOHURA NË MATEMATIKË				GJYQTARI SPORTIV / SPËRKATJE ME UJË, UJITJE						
KOHA	KËNGËTARI, GETOAR (GHETTO GEASY) / ORGANI I TË FOLURIT							SAMARIUMI / JETË E QETË DHE E LUMTUR		
GRAMI		FILOZOFI KOSOVAR, SHKËLZEN / RAJON INDUSTRIAL NË GJERMANI							Ë / UNË (LAT.)	
FUTBOLLISTI BELGJIAN, DIVOK						ZAKON, TRADITË / TANTALI				
PËREMËR VETOR			PUNA TINËZAKE, DREDHIA / KALIUMI							
HARKU QË LIDH DY SHTYLLAT E PORTAVE (ARKITEKTURË)							FILOZOFI ANGLEZ, XHON			

Sudoku

mesatar

	2							
6	5	3						
		8	3			9		1
				2		4	7	9
		4	8					
								3
	4				3		5	7
		6		1		2		
		1		4				6

shumë i lehtë

						1	4	
7	5	9			4		8	
4				8		5		
	2			6	5		1	
6			1		7			8
			2	3				
9		6		7			5	
8	1				6		7	
						8	9	

ZGJIDHJET: K, RAMA, ERAL, BASRA, TEKS, PINOK, NAVA, HALEN, KASTRAT, RI, NOJER, RAMA, BARCELONA, IKS, REFERI, SELIMI, SM, G, MALIQI, Ë, ORIGI, ADET, JU, INTRIGA, ARKADA, LOK.

Shumë i lehtë: 283659147, 759314682, 461782539, 328965714, 695147328, 174238965, 946873251, 812596473, 537421896. **Mesatar:** 129476538, 653189742, 478352961, 385621479, 914837625, 267594813, 842963157, 536718294, 791245386.

SHKENCA KA NJË LAJM TË MIRË PËR GJUMASHËT

Sasia e rekomanduar e gjumit për të rriturit është gjashtë deri në tetë orë në natë. Duke fjetur më shumë se kaq, rritet edhe rreziku i vdekjes dhe sëmundjeve kardiovaskulare, thotë një studim global botuar të mërkurën në Gazetën Evropiane të Zemrës. Duke parë të dhënat nga 21 vende, në shtatë rajone, ekipi hulumtues zbuloi se njerëzit që flinin më shumë se kufiri i vendosur prej tetë orësh rrisnin rrezikun e problemeve madhore kardiovaskulare, siç janë goditja e zemrës ose dështimi i zemrës, si dhe vdekja deri në 41%. Por një arsye e mundshme për këtë mund të jetë se "gjumashët" paraprakisht mund të kenë probleme të caktuara shëndetësore, që i bëjnë ata të flenë më gjatë, shpjegojnë autorët e studimit. Ekipi, i udhëhequr nga Chuangshi Wang, Ph.D. student në McMaster, gjithashtu identifikuan një rrezik në rritje nga personat që flinin ditën.

Studimet e mëparshme në lidhje me këtë temë u zhvilluan kryesisht në Amerikën e Veriut, Evropë dhe Japoni. Studimi i ri sjell një pamje globale. Por gjetjet janë ende në vëzhgim, që do të thotë se shkaku i problemeve të zemrës dhe rreziqeve nga vdekje mbetet i panjohur.

KALENDARI HISTORIK 28 MARS

193 - Perandori romak vritet nga Garda pretoriane, të cilët pastaj shesin fronin në ankand Didius Julianit.

1556 - I biri i Karlit V, Filipi II kurorëzohet mbret i Spanjës.

1738 - Parlamenti anglez i shpall luftë Spanjës.

1799 - Shteti i Nju Jorkut shfuqizon robërinë.

1845 - Meksiko ndërpret marrëdhëniet diplomatike me SHBA

1920 - Thomas Masaryk zgjidhet kryetar i Çekosllovakisë

1930 - Konstantinopoja dhe Angora i ndërrojnë emrat në Stamboll dhe Ankara.

1969 - Poeti grek dhe fituesi i Çmimit Nobel Giorgos Seferis bën një fjalim të famshëm në BBC duke kundërshtuar juntën në Greqi.

1993 - Konservativët fitojnë zgjedhjet parlamentare në Francë.

Gjykatësja ia ndalon të arrestuarit të pijë "Pepsi" për katër vjet

Gjatë javës së kaluar, gjykatësja nga Hawaii me emrin Rhonda Loo, e shqiptoi një dënim interesant ndaj 21-vjeçarit Christopher Montilliano Jr., i cili ishte arrestuar për vjedhje veturash. Ajo e urdhëroi atë që të mos e konsumojë për katër vjet pijen "Pepsi", meqë ai në momentin e arrestimit i kishte gënjyer policët se kushëriri i tij i kishte dhënë veturën me leje që të shkonte të blinte këtë pije. Kur ajo e kuptoi se kjo është pija e tij e preferuar, vendosi ta shqiptonte këtë dënim ndaj tij. "Është sindroma e deprivimit të Pepsit", deklaroi ajo. Montilliano kaloi shtatë ditë në burg pas arrestimit, ndërkaq gjatë kësaj kohë avokati i tij gjatë seancës në gjykatë tha se i riu e kishte kuptuar rëndësinë e respektimit të ligjit. "Nuk do të vjedh më vetura", i tha ai gjykatëses. "Nuk dua të rri më në burg". Loo gjithashtu e dënoi Montillianon me 100 orë shërbim të komunitetit dhe një gjobë prej 100 dollarësh.

Kush fut më shumë biskota në gojë, vdes 24 vjeçarja

Një 24-vjeçare nga Britania e Madhe i shkaktoi vdekjen vetes së saj, pasi e bllokoi frymëmarrjen duke provuar të fuste sa më shumë biskota "Jaffa" në gojën e saj. E reja ndërroi jetë, pasi loja që nisi si sfidë gjatë një feste shkoi keq dhe rrugët e frymëmarrjes ju bllokuan. Bethan Gaskin, iu errësua pamja dhe ndaloi së marri frymë kur i mbetën biskotat në fyt, ndërsa provonte t'i largonte nga goja. 24-vjeçarja, që ishte nënën e një fëmije humbi ndjenjat në shtëpi dhe u dërgua me urgjencë në spitalin e Lincolnshire për trajtim. Kur mbërriti në qendrën spitalore, e reja me profesion terapiste estetike pësoi sulm në zemër dhe ndërroi jetë pas pesë ditësh.

Nëntë infermiere nga i njëjti spital, shtatzënë në të njëjtën kohë

Nëntë infermiere në një spital në Maine, janë në pritje të një fëmije, të cilat do të lindin në të njëjtën kohë. Infermieret në Qendrën Mjekësore në Maine të Portland, do të sjellin në jetë fëmijë në mes të prillit dhe korrikut. Spitali njoftoi shtatzënitë të hënën përmes rrjeteve sociale dhe uroi nënat. Tetë prej tyre u paraqitën në foto me barkë të fryrë. Spital iu përgjigj shqetësimeve të disa njerëzve lidhur me stafin gjatë verës duke komentuar 'mos u shqetëso, ne kemi një plan'. Infermieret e kanë mbështetur njëratjetrën që nga fillimi dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë derisa të lindin të gjitha.

A E DINI SE...

Në Japoni nëse dikush bën vetëvrasje duke u hedhur para një treni, familja e të ndjerit gjobitet për ndërprerje të qarkullimit të trenit.

Në një klub me bazë 25 km jashtë Teheranit, rreth 4000 gra iraniane ushtrojnë të bëhen "kunoiçi", një term modern për ninxhat femra.



Në Itali nuk konsiderohet vepër penale, nëse vjedh ushqim për të ngrënë, nëse nuk ke asnjë punë apo asistencë.

BARSOLETA

PIKTORI

Një piktor, fshehtas gruas, kishte ftuar të dashurën në shtëpi, që të çojë dashuri me të.

Gruaja kthehet befas në shtëpi dhe piktori i thotë të dashurës:

- Zhvishu se gruaja do të më bëj problem po të gjeti të veshur!

THËNIA E DITËS



Njerëzit të braktisin për një gabim, kurse Zoti të pranon me një mal gabimesh, andaj mos u humb shpresat nga Ai. **(Paul Walker)**